

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10416 datë 7.4.2011, Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” të ndryshuar.
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Nuk ka përafrim me legjislacionin e BE-së
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 460, datë 29.6.2022” Për miratimin e strategjisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 2021-2027; Programi i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë; Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 366, datë 16.6.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023–2027”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	2.5.2024/ – 31.5.2024
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	18/122024
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 29.05.2024
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2024 – MBZHR- Nr. 4
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	<i>Emri:</i> Alban Isufi <i>e-mail-i:</i> alban.isufi@bujqesia.gov.al numri i telefonit: <i>Emri:</i> Entela Kola <i>e-mail-i:</i> entela.kola@bujqesia.gov.al numri i telefonit: <i>Emri:</i> Adra Gjongecaj <i>e-mail-i:</i> adra.gjongecaj@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0692325402
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?</i> Shkaqet janë: - Mungesa e akteve nënligjore, të cilat nuk janë miratuar ndër vite, krijojnë pamundësi në zbatimin korrekt të ligjit.	

- Mungesa e një autoriteti kompetent i cili do të bënte monitorimin dhe inspektimin si dhe sigurimin e zbatimit të ligjit përmes masave administrative në rastet e shkeljes së dispozitave të caktuara¹.

Bazuar në kontekstin e projektligjit për materialin mbjellës dhe shumëzues, shkaqet, problematikat kryesore të evidentuara në zbatimin e ligjit ekzistues dhe pasojat e problematikave janë si më poshtë:

1. Mungesa e harmonizimit me standardet ndërkombëtare

- **Problematika:** Legjislacioni aktual nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke krijuar pengesa në tregtinë dhe përdorimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.
- **Pasojë:** Prodhuesit vendas përballen me vështirësi për të hyrë në tregjet ndërkombëtare dhe për të konkurruar me produkte të tjera në nivel ndërkombëtar.

2. Mbikëqyrje dhe kontroll i dobët

- **Problematika:** Sistemet ekzistuese të mbikëqyrjes dhe kontrollit të cilësisë së materialeve mbjellëse dhe shumëzues janë të dobëta ose joefektive. Aktualisht, nuk janë të përcaktuara qartë kërkesat për rianalizim të fuqisë mbirëse të materialeve mbjellëse dhe procedurat për certifikimin zyrtar.
- **Pasojë:** Mungesa e rregullimit të tillë çon në një mbikëqyrje të pamjaftueshme të cilësisë së materialeve në treg dhe uljen e besimit të konsumatorëve.

Në treg qarkullojnë produkte me cilësi të ulët, të cilat ndikojnë negativisht në prodhimtarinë bujqësore dhe në besimin e konsumatorëve.

3. Përcaktime të paqarta ligjore për operatorët dhe përgjegjësitë

- **Problematika:** Ligji aktual nuk përcakton qartë përgjegjësitë e operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve mbikëqyrëse për menaxhimin dhe tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues.
- **Pasojë:** Ka mungesë përgjegjësie dhe llogaridhënieje nga operatorët ekonomikë dhe organet mbikëqyrëse.

4. Mungesa e dokumentacionit gjurmues dhe certifikimit

- **Problematika:** Nuk ekziston një sistem i detajuar dhe i detyrueshëm për gjurmimin dhe certifikimin e origjinës dhe cilësisë së materialeve mbjellëse dhe shumëzues.
- **Pasojë:** Fermerët dhe prodhuesit hasin vështirësi për të siguruar inpute bujqësore të sigurta dhe cilësore.

5. Promovimi i kufizuar i përdorimit të materialit autokton dhe të qëndrueshëm

- **Problematika:** Politikat ekzistuese nuk mbështesin mjaftueshëm përdorimin e materialeve mbjellëse dhe shumëzues autoktonë dhe të qëndrueshëm.
- **Pasojë:** Kjo ka çuar në uljen e biodiversitetit bujqësor dhe në përhapjen e varietetesh të paqëndrueshme në disa rajone.

6. Kornizë ligjore e përditësuar me ritme të ngadalta

¹ Në vitin 2020 u miratua krijimi dhe funksionimi i Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve me VKM Nr. 683, datë 2.9.2020.

- Problematika: Ligji nuk është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme për të reflektuar përparimet shkencore dhe teknologjike në bujqësi.
- Pasojë: Ka një hendek midis zhvillimeve aktuale të sektorit dhe legjislacionit në fuqi.
- Problematikë: Aktualisht, proceset e regjistrimit dhe rinovimit të varieteteve nuk janë tërësisht të dixhitalizuara dhe nuk ofrohet një qasje transparente në informacionin publik, si katalogët e varieteteve.
- Pasojë: Procedurat mbeten komplekse dhe kërkojnë ndërhyrje manuale, duke rritur ngarkesën administrative dhe ulur aksesin e menjëhershëm të palëve të interesuara në informacionin e përditësuar.
- Problematika: Ligji ekzistues nuk adreson në mënyrë efektive potencialin për të rritur konkurrueshmërinë e sektorit dhe për të ndikuar pozitivisht në zhvillimin rural.
- Pasojë: Prodhimi bujqësor dhe zinxhiri i vlerës mbeten të kufizuara në krahasim me kapacitetet e mundshme.

Grupet e interesit të prekura nga ky problem janë:

- ✓ *Qeveria* - rritje e të ardhurave, rritje e standarteve bujqësore, avantazh në plotësimin e parakushteve të BE-së, rritje e të ardhurave nga sigurimet shoqërore shëndetësore si rrjedhojë e rritjes së punësimit etj.
- ✓ *Operatorët* - e biznesit që importojnë, eksportojnë, prodhojnë, ruajnë dhe tregtojnë material mbjellës dhe shumëzues bimor, i cili është përgjegjës për t'i siguruar konsumatorit farëra dhe fidanë të certifikuar njëkohësisht të pastër nga ana fitosanitare;
- ✓ *Fermerët* - të cilët janë përgjegjës për zbatimin e masave si dhe respektimin e etiketave zyrtare për mbjelljen e tyre për t'i ofruar konsumatorit produkte të sigurta;
- ✓ *Qytetarët* - konsumatorë të cilët paguajnë për produkte të sigurta dhe cilësore me cmime konkurruese.
- ✓ *Punëmarrësit* - më shumë vende pune do të hapen jo vetëm në fushën e përpunimit dhe tregëtimit të materialit mbjellës shumëzues e bimor por edhe në sektorin e bujqësisë si tërësi.

Sa më sipër, synohet ndërhyrja e qeverisë për të përmirësuar njohjen dhe evidentuara çdo hallke të zinxhirit ushqimor, duke garantuar shëndetin publik dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorit. Ja disa nga arsyet dhe synimet kryesore të këtij propozimi:

Arsye për Ndërhyrjen e Qeverisë

1. Formalizimi i tregut: Marketingu i drejtpërdrejtë nga fermeri te konsumatori ka krijuar një ekonomi gri në sektorin bujqësor. Ndërhyrja synon të formalizojë këtë treg, duke rritur njohuritë dhe duke ulur barrierat administrative për fermerët.
2. Siguria ushqimore: Përmirësimi i kontrollit të origjinës së produkteve bujqësore dhe blegtorale për të rritur sigurinë ushqimore në tregjet bujqësore dhe blegtorale.
3. Certifikimi i materialit mbjellës: Rritja e kontrollit dhe cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për të përmbushur standardet e BE-së dhe për të siguruar një nivel të lartë të prodhimit vendas dhe bujqësisë organike.
4. Eliminimi i burokracisë: Përmirësimi i procedurave administrative për funksionimin e Komisionit të Regjistrimit dhe procedurës së regjistrimit, certifikimit dhe importit të materialit mbjellës.

Përfitimet e Ndërhyrjes

- Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë së materialeve mbjellëse dhe shumëzuese bimore.
- Harmonizimi i proceseve me standardet ndërkombëtare.
- Rritja e transparencës dhe digjitalizimit të proceseve.
- Përmbushja e standardeve të BE-së për agronominë dhe tregtinë e materialeve bimore.

Kjo ndërhyrje është e nevojshme për të rregulluar më mirë tregun e materialeve mbjellëse dhe shumëzuese bimore, për të përmirësuar cilësinë dhe sigurinë e këtyre materialeve, dhe për të harmonizuar proceset me standardet ndërkombëtare. Qeveria synon të trajtojë sfidat e burokracisë, mungesës së qartësisë në përgjegjësitë institucionale dhe nevojën për digjitalizim dhe transparencë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Politika e propozuar synon realizimin e objektivave si më poshtë:

1. Efektiviteti në rritjen e eksporteve nëpërmjet garantimit të cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të vendosur në treg brenda me 15% brenda vitit 2030;
2. Efektiviteti i mekanizmave të vendosur për rritjen e numrit të certifikimeve të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me 20% brenda vitit 2029;
3. Plotësimi i legjislacionit në fushën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me akte nënligjore përmes të cilave do të bëhet i mundur zbatimi i rregullave dhe kriterëve të reja ligjore të parashikuara me këtë projektligji brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e projektligjit;
4. Efektiviteti i procedurave më të thjeshta për regjistrimin e variteteve të reja të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në Katalogun Kombëtar pas hyrjes në fuqi të këtij projektakti.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Gjatë analizës së kryer, janë shqyrtuar katër opsione për përmirësimin e kuadrit ligjor për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor:

Opsioni 0: Status quo. Mosndërhyrja me ligj të ri; Ky opsion do të thotë të vijohet të mbeten problematikat aktuale duke mos adresuar zgjidhjen e tyre. Ligji Nr. 10416 datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” të ndryshuar,

Avantazhet:

- Kostot e ulëta administrative dhe ligjore.

- Eliminimi i vonesave dhe sfidave që lidhen me adaptimin e kuadrit të ri ligjor.

Disavantazhet:

- Problemet aktuale nuk adresohen, duke çuar në uljen e cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues.
- Mosarmonizimi me standardet e BE-së pengon zhvillimin dhe aksesin në tregjet evropiane.
- Ligji aktual nuk mbështet zhvillimin e bujqësisë organike.

Opsioni 1: Kryerja e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin aktual.

Ky opsion konsiston në kryerjen e shtesave dhe ndryshimeve në Ligjin Nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor,” për të adresuar problemet e hasura gjatë zbatimit të tij. Synohet eliminimi i mangësive aktuale dhe përshtatja e ligjit me kërkesat e reja dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE).

Avantazhet:

- Zgjidhje më e shpejtë dhe më pak e kushtueshme.
- Harmonizim me draft-rregulloren e re të BE-së.
- Përditësimi i strukturave dhe emërtesave sipas ligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Disavantazhet:

- Zgjidhje afatshkurtër dhe e pjesshme.
- Mund të shtojë kompleksitetin e ligjit ekzistues.
- Pasiguri mbi afatet dhe përmbajtjen e rregullores së re të BE-së.

Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”. Ky opsion përfshin hartimin e një ligji të ri për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, duke zëvendësuar tërësisht ligjin ekzistues. Qëllimi do të ishte krijimi i një kornize të re dhe më të avancuar ligjore, e përshtatur me praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe standardet e Bashkimit Evropian (BE).

Avantazhet:

- Mundësi për të rishikuar dhe përshtatur të gjithë kornizën ligjore.
- Harmonizim i plotë me standardet e reja të BE-së.
- Bazë e qëndrueshme për menaxhimin dhe rregullimin e sektorit në një horizont më të gjatë kohor.

Disavantazhet:

- Kosto e lartë dhe zgjatje e procedurave.
- Pasiguri mbi përputhjen me rregulloren e re të BE-së.
- Rreziku i përfshirjes së çështjeve të panevojshme.

Opsioni 3: Jorregullator

Ky opsion fokusohet në ndërmarrjen e masave jorregullatore, duke inkurajuar operatorët ekonomikë të adoptojnë praktika të mira për sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me standardet. Në këtë kontekst, mund të krijohen programe edukimi, fushata ndërgjegjësimi dhe udhëzime teknike për operatorët që ofrojnë materiale mbjellëse dhe shumëzuese bimor. Gjithashtu, mund të promovohet vetë-rregullimi përmes kodeve të sjelljes dhe standardeve vullnetare të sektorit.

Avantazhet:

- Kosto më të ulëta dhe fleksibilitet për operatorët ekonomikë.
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi ndihmojnë në ngritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve.

- Mundësi bashkëpunimi mes sektorit privat dhe institucioneve përmes iniciativave vullnetare.

Disavantazhet:

- Mungesë detyrueshmërie dhe monitorim i kufizuar.
- Ndryshimet në sjellje dhe standarde mund të ndodhin me ritme të ngadalta.
- Operatorët më të vegjël mund të mos kenë kapacitetet për të ndjekur udhëzimet.

Përfundim

Opsioni 1, kryerja e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin aktual, paraqet një qasje pragmatike dhe me kosto të ulët për të adresuar problemet aktuale dhe për të përgatitur strukturat ligjore dhe institucionale për ndryshimet e ardhshme të BE-së. Megjithatë, është një zgjidhje e pjesshme që mund të kërkojë përsëritje të procesit në të ardhmen. Opsioni 2, hartimi i një ligji të ri, garanton zgjidhje afatgjatë dhe gjithëpërfshirëse, por është më kompleks dhe i kushtueshëm. Opsioni 3, jorregullator, është fleksibil dhe me kosto të ulëta, por mund të mos garantojë përputhshmëri dhe cilësi uniforme në nivel kombëtar.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndryshimet e propozuara në ligjin për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor do të kenë ndikime të rëndësishme mbi grupet e interesit të përfshira. Ja një përmbledhje e grupeve të prekura dhe ndikimet kryesore për secilin grup:

Grupet e Interesit dhe Ndikimet

1. Qeveria

- Rritje e të ardhurave: Përmirësimi i standardeve bujqësore dhe plotësimi i parakushteve të BE-së.
- Rritje e punësimit: Rritje e të ardhurave nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

2. Operatorët e biznesit

- Përmirësimi i cilësisë: Investime në dokumentacion, certifikata cilësie dhe teknologji.
- Rritja e konkurrencës: Avantazhe tregtare për ata që përshtaten më shpejt.
- Shpenzime shtesë: Kërkesat e reja mund të rrisin shpenzimet, por edhe përfitimet afatgjata.

3. Fermerët

- **Qasje në materiale cilësore:** Përmirësimi i standardeve për materialet mbjellëse.
- **Rritja e ndërgjegjësimit:** Trajnime dhe fushata ndërgjegjësuere mbi përdorimin e materialeve të certifikuara.
- **Kosto më të larta:** Materialet e certifikuara mund të jenë më të kushtueshme, por me përfitime më të mëdha në rendiment.

4. Qytetarët (konsumatorët)

- **Produkte më cilësore:** Rritja e standardeve për materialet mbjellëse do të ndikojë në cilësinë e produkteve bujqësore.
- **Ndikimi në çmime:** Përmirësimet në cilësi mund të sjellin rritje të lehtë të çmimeve.
- **Përfitime afatgjata:** Produkte më të sigurt dhe më cilësore përmirësojnë shëndetin dhe mirëqenien.

5. Punëmarrësit

- **Më shumë vende pune:** Hapja e vendeve të reja të punës në përpunimin dhe tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, si dhe në sektorin e bujqësisë.

Ndikimet Ekonomike, Financiare, Sociale dhe Mjedisore

Pozitive:

- **Ekonomike:** Rritja e formalizimit të tregut, lehtësimi i biznesit, mbështetja për eksportuesit, rritja e investimeve dhe hapja e tregtisë ndërkombëtare.
- **Financiare:** Ulja e kostove për furnizuesit që ndjekin standardet, reduktimi i ngarkesës financiare të qeverisë.
- **Sociale:** Rritja e sigurisë për konsumatorët dhe fermerët, transparencë më e madhe përmes publikimeve online.
- **Mjedisore:** Promovimi i përdorimit të materialeve cilësore, mbikëqyrja e varieteteve OMGJ për të shmangur ndikimet negative mjedisore.

Negative:

- **Ekonomike:** Rritja e përgjegjësisë për furnizuesit mund të rrisë kostot e operimit, kufizimi i tregut për ata që nuk përmbushin kërkesat e reja.
- **Financiare:** Shpenzime shtesë për laboratorët dhe institucionet përgjegjëse për kontrollet dhe analizat.
- **Sociale:** Kufizime për disa prodhues dhe tregtarë që nuk plotësojnë kriteret, çka mund të shkaktojë ankesa ose rezistencë.
- **Mjedisore:** Nëse kontrollet dhe certifikimet nuk zbatohen siç duhet, mund të ketë ndikime negative nga përdorimi i varieteteve jo të sigurta.

Pamundësia për Analizë Sasiore

Aktualisht, është e pamundur të kryhet një analizë sasiore e kostove për shkak të mungesës së të dhënave të detajuara për koston e implementimit të ndryshimeve të propozuara. Faktorë të tillë si numri i bizneseve të përfshira, lloji i teknologjisë së përdorur, sasia e materialit të përpunuar dhe ndryshimet në treg e bëjnë të vështirë realizimin e një analize sasiore financiare në këtë moment. Për të realizuar një analizë të saktë, do të nevojitet kohë për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit, përmirësimin e kuadrit rregullator dhe përfshirjen e ekspertëve financiarë dhe teknikë. Këto kosto do të mund të përlllogariten dhe përcaktohen nëpërmjet akteve nënligjore që do të miratohen pas miratimit të projektligjit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është përzgjedhur opsioni 1, i cili ka si qëllim realizimin e ndryshimeve ligjore përmes të cilave do të përcaktohen kompetencat në mënyrë definitive të institucioneve përgjegjëse sipas fushës së përcaktuar që mbulojnë duke përmbushur detyrimin për ndjekjen e të gjitha hallkave nëpër të cilat kalon procesi i trajtimit të materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.

Konkretisht ky projektligj, ka përmirësuar strukturat, procedurën dhe kërkesat për regjistrimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në katalogun kombëtar: - është përcaktuar se aplikimi për regjistrimin kryhet në sistemin on-line në platformën ndërqeveritare e-albania, duke saktësuar dhe dokumentacionin e kërkuar; - janë cituar më qartë dhe thjeshtë kushtet që

duhet të plotësojë një variatet për t'u regjistruar në Katalogun Kombëtar; - ka përcaktuar rolin dhe funksionin e Komisionit të Regjistrimit të Varieteteve (KRV), si organ kolegjal teknik, i përhershëm dhe vendimmarrës, i cili funksionon në mënyrë periodike në procedurën e regjistrimit të varieteteve; - rregullon ofrimin e informacionit për grupet e interesit, institucionet zyrtare të kontrollit si dhe për fermerët apo palë të tjera të interesuara, nëpërmjet publikimit të Katalogut Kombëtar në faqen zyrtare të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe të Ministrisë si dhe përditësimin sa herë që pëson ndryshime.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?) çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10416 datë 7.4.2011, Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimorështëpublikuar për konsultim publik në Regjistrin Elektronik të Konsultimit Publik në ëësite <http://ëëë.konsultimipublik.gov.al>. Procesi i konsultimit përmes regjistrimit elektronik në RENJK zgjati nga data 2.5.2024 deri më 31.5.2024. Gjatë kësaj periudhe u realizua një takim në MBZHR (datë 31.5.2024 ora 9:00) me grupet e interesit të përfaqësuar nga: Hiqmet Skënderi, Ruzhdi Koni (AgroKoni), Agim Rameta (AFADA), Naim Allmeta PF, Ornela Malja (MBM shpk), Agim Boja (ECO-GREEN SHPK), Astrit Mara (AGROBLEND), Gëzim Pllaha (LOREN SHPK). Gjithashtu është komunikuar dhe përmes postës elektronike. Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimin publik, janë:

Z. Endrit Kullaj, Pedagog në Univesitetin Bujqësor të Tiranës: komunikim përmes postës, në lidhje me përcaktimin e diplomave, për të cilën është pranuar dhe reflektuar pjesërisht ka dhënë komentin: “Në Nenin 7 qe ndryshon Nenin 11, pika 5 (a) dhe Nenin 10 që ndryshon Nenin 23 pika 1 (a), diploma e njohur si drejtues teknik është ajo e agronomise - ne fakt ky është nje emertim i vjeter, qe daton para viteve 1990. Aktualisht, diplomat emertohen Inxhinier Agrar me profile te ndryshme: Agronomi, Hortikulture, Mbrojtje Bimesh, Agromekanizim, etj. Gjykoj se mund te lihet emertimi Inxhinier Agrar si me i pergjithshem dhe qe perdoret si i tille prej 20 vitesh.”

MBZHR ka shprehur qëndrimin se është komenti është pranuar pjesërisht dhe sqaron se përcaktuar fusha e agronomisë për drejtuesin Teknik pasi është e njëjtë dhe për ligjet e tjera, me argumentin për të mos krijuar konfuzion në implementim dhe njëkohësisht përmbushet detyrimi për drejtuesin Teknik.

Z. Hiqmet Skënderi komunikim përmes postës elektronike dhe takim në MBZHR, ka komentuar “Neni 1, shkronja d), me përjashtim të shkronjës a) të pikës 2 të nenit 11.Nuk ka lidhje; ndoshta; me përjashtim te pikes b)?”

MBZHR ka pranuar dhe reflektuar këtë koment.

“Neni 3 “Shkronja “a” e pikës 7, të nenit 4 riformulohet si vijon: “a) Varieteti është i regjistruar në Katalogun Kombëtar, me përjashtim të neneve 6 dhe 10 të këtij ligji”. Mendoj se duhet formuluar:” ...me përjashtim të rasteve te parashikuara ne nenet 6 dhe 10 të këtij ligji”.

MBZHR ka pranuar dhe reflektuar pjesërisht këtë koment.

“Neni 7/ 3. Pas pikës 8 shtohet pika 9 me përmbajtjen si vijon: “9. Çdo 6 muaj furnizuesi kryen rianalizimin për fuqinë mbirëse për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të vendosur në

treg”.Perse duhet rianalizuar fara cdo 6 muaj? Perse p.sh. fara e grurit duhet rianalizuar ne Shkurt kur vlefshmeria e certifikates eshte 6 muaj? Gruri fillon te mbillet ne Tetor, pra, pas 8 muajsh. E njejta gje edhe per kulturat e tjera. Fara duhet te jete e shoqeruar me certifikate cilesie ne momentin e tregetimit dhe jo gjate periudhes se ruajtjes.Per me teper, perse teknikalitete te tilla duhet te vendosen ne ligj? Keto mund te percaktohen me akte nenligjore.”

MBZHR ka pranuar dhe reflektuar komentin.

“Neni 9 mendoj qe ky nen duhet te hiqet. Ndryshimi i pikës 4 të nenit 16 mund të përfshihet në nenin 5 së bashku me rastet e tjera të njejta”.

MBZHR ka pranuar dhe reflektuar pjesërisht këtë koment.

“Neni 14/1. Kërkesa për regjistrimin e një varieteti kryhet në sistemin on-line në platformën ndërqeveritare e-albania dhe përmban: a) dokumentin që vërteton provën e kryer për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet (DUS); DUS vërteton thjesht qe kemi të bëjmë me nje varietet te ri, te dallueshem nga gjithe varietetet e tjera te regjistruara. Përfshirja e një varieteti në Katalogun e OECD ose ate te BE, presupozon që DUS është kryer. Mendoj qe pika a) duhet formuluar:dokumentin që vërteton provën e kryer për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet (DUS) ose deklarimin nga prodhuesi që varieteti është i përfshirë në Katalogun e OECD ose atë të BE;

MBZHR ka pranuar dhe riformuluar pjesërisht këtë koment.

“Ne nenin 4 te ligjit Nr.10 416, datë 7.4.2011 Pika 1 me permbajtje:“1-Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i specieve të veçanta të bimëve, të përcaktuara sipas këtij ligji, tregtohet nëse plotëson kërkesat për cilësitë e kategorive të përcaktuara të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.”Mendoj të riformulohet si më poshtë:1-Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i specieve të veçanta të bimëve, të përcaktuara sipas këtij ligji, tregtohet nëse shoqërohet me certifikate që verteton plotësimin e kërkesave për cilësitë e kategorive të përcaktuara të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor. Ky ndryshim do shmange gjobën ndaj subjekteve ne rastet kur ka rënie të treguesve cilësore të ndonje loti fare për të cilin subjekti ka të gjithë dokumentsntacionin ligjor te percaktuar, perfshire certifikaten e vlefshme te cilësisë. Detyrimi i subjekteve është që materialin mbjelles t`a blejnë të shoqeruar me dokumentacionin ligjor të përcaktuar. Mund të ndodhë me vonë (edhe brenda afatit ligjor te vlefshmerisë së certifikatës që treguesit cilësore te bijen. Materiali mbjellës bimor është organizëm i gjallë dhe mbi të ndikojnë shumë faktorë, prandaj këto ndryshime nuk janë pergjegjesi e subjektit. Bllokimi i materialit mbjellës është dëm shumë i madh ekonomik për ta dhe është e paarësyeshme të gjobiten. Me të njejtin aresyetim, mendoj që në nenin 54 (Sanksionet) pika 7 me përmbajtje:”7. Për shkeljet e parashikuara në pikën 8, gjobë 30 mijë deri në 50 mijë lekë dhe merret masë sekuestrimi, asgjësim e kthim në vendin e origjinës.”te riformulohet:7. Për shkeljet e parashikuara në pikën 8, merret masë sekuestrimi, asgjësim ose kthim në vendin e origjinës. Në nenin 4 pas shkronjes d) të pikës 7 te ligjit Nr.10 416, datë 7.4.2011 mendoj se duhet të shtohet: e) në raste të vecanta, lejohet tregetimi i materialit mbjelles të certifikuar, me shmangie të treguesve cilesore, duke bere korrektime e nevojshme. Këto raste, përcaktohen me urdhër Ministri. Ka raste që lotë të caktuara fare kanë shmangje të vogla te treguesve cilësore. Duke korektuar normën e farës, këto lotë mund të përdoren pa shkaktuar asnjë problem per prodhimin. C`te keqe do sillte p.sh. përdorimi i farës së grurit me fuqi mbirëse 80% (kur standarti është 85%) nëse do rritim normën e farës 5%. Kjo vetëm për materialin mbjellës të certefikuar dhe jo për të bërë certifikim të materialit mbjellës ose per të lejuar import të tij kur nuk plotëson kërkesat për treguesit cilësore.

MBZHR për secilin për nenet sipas komentit janë pranuar dhe reflktuar pjesërisht në projekligj.

Z. Pjerin Preka (AgroKoni), takim në MBZHR, ka dhënë komente në lidhje me shëndetin e bimëve,:

“Gjithashtu mungojnë listat e sëmundjeve dhe të dëmtuesave specifike sipas specieve e kultivarëve të materialit të shumzimit që importohet të cilat duhet të jenë subjekt i këtij ligji. Në qoftë se ligji nuk rregullon importin dhe eksportin e nënshartesave dhe të kultivarëve dhe nuk kontrollon sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve të reja atëherë për çfarë shërben ai?”

MBZHR sqaron lidhur me komentin se është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në projekligj dhe njëkohësisht sqaruar në realacion dhe është nën i veçantë i cili përcakton qartë shëndetin e bimëve.

Z. Agim Rameta (AFADA), komunikim përmes postës elektronike, shkresë zyrtare dhe takim në MBZHR, ka pas komente:

“Së pari, vendosja e kriterit nëse subjektit profesionist i lejohet të shesë apo jo produkte subjekteve të tjera (rasti i shitjes së PMB-ve drejtë Subjekteve të tjera profesioniste ose vet fermerëve shqiptarë). Në këtë pikë, lista e subjekteve të licensuara është objekt i kontrollit të institucioneve shtetërore dhe jo e subjekteve private. Nga pikëpamja e informimit dhe nga e drejta për të patur informacion, subjektet e kanë të pamundur të kenë informacion mbi të gjithë licensimet në rang vendi. Një rast tjetër teknik në lidhje me fermerët dhe që e kemi hasur në punën tonë ditore; fatura tatimore tregon se kush do të ketë në pronësi mallin e blerë, por jo domosdoshmërisht se kush do ta përdori këtë mall. Fermerët mund të kërkojnë ndihmën e agronomëve lokal për përdorimin e inputeve bujqësore dhe fatura tregon vetëm se në pronësi të kujt do të shkojë malli i shitur nga subjektet profesioniste. Pra, si përfundim, subjektet nuk kanë të drejtë verifikimi deri në fund të zinxhirit të inputit bujqësor të shitur.

-MBZHR për këtë koment sqaron se është përcaktuar fusha e agronomisë për drejtuesin Teknik pasi është e njëjtë dhe për ligjet e tjera, me argumentin për të mos krijuar konfuzion në implementim dhe njëkohësisht përmbushet detyrimi për drejtuesin Teknik. Komenti është pranuar dhe është reflektuar.

-2. Në shumë prej procedurave të licensimit në fushën e agrobiznesit, është përmendur kriteri i drejtuesit Teknik i cili duhet të jetë i pajisur me kontratë me kohë të plotë pune. Bizneset janë të drejtura nga drejtues Teknik të cilët qëndrojnë Brenda territorit të punës, adresës ku edhe kanë certifikatën e regjistrimit. Dhe përgjithësisht kjo certifikatë përmbledh një sipërfaqe pune në një vend të caktuar. Në kontrollet e institucioneve përgjegjëse, është interpretuar se për licensa të ndryshme duhen drejtues Teknik të ndryshëm, prej kriterit “me kohë të plotë”. Subjektet profesioniste për të njëjtën licensë kanë të njëjtin drejtues Teknik sepse është po ai në vendin e ushtrimit të profesionit në subjekt. Është një ambient, mbase i ndarë në mjedise të ndryshme (farnat përshembull janë të ndara vec nga PMB-të), por edhe shitja përmbledhet më pas në një faturë tatimore, dhe jo në njësi të vecanta dhe të ndara.

MBZHR sqaron se është marrë në konsideratë komenti dhe sqaruar në relacion ku sqarohet se i njëjti drejtues teknik vlen për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, produkte plehëruese dhe produktet e mbrojtjes së bimëve.

3. Vëmë re se keni ndarë të drejtat e institucioneve të caktuara por ajo që kërkojmë ne është që të ndahet edhe e drejta e importimit të farnave sipas importuesit. Një regjistrim kërkon studim tregu, plotësim dokumentacioni dhe efekte financiare të cilat nuk ka pëse të përfitohen pa të drejtë nga biznese të tjera të cilat kërkojnë të fusin edhe në mënyrë joligjore në Shqipëri. Për të patur më shumë siguri dhe kontroll duhet bërë e mundur që importimi i farnave të kryhet vetëm

nga Firma e cila ka ndjekur regjistrimin e produktit. Ju japim në këtë rast në vëmendje për shqyrtim rastin e importimit të plehërave të ndryshme kimike.

MBZHR sqaron se komenti u pranua dhe reflektua pjesërisht.

4. Analiza e Farnave. Vumë re se ishte prekur në ndryshim edhe procedura e analizimit të farnave. E shohim të arsyeshme t'ju sjellim në vëmendjen Tuaj, faktin se nëse një farë del pas analizës se ka një fuqi mbirëse më pak se 80%, të lejohet shitja e farës me kusht rregullim me rritjen e dozës së përdorimit. Në këtë mënyre, do të shmangim shpërdorimin e farës e cila do duhej të hidhej, ndërkohë që rritja e dozës do të sillte optimizim të farës. Kjo do të sillte efekte positive edhe në qarkullimin më optimal të farnave në vendin tonë.

MBZHR sqaron se ky koment u mor në konsideratë dhe u reflektua pjesërisht.

5. Pika që ka të bëjë me gjobat në lidhje me tregtimin e inputeve bujqësore. Jo pak herë ka ndodhur që për të njëjtën farë, me të njëjtin lot, pasi është marrë për analizë nga AKU-ja, dhe është vendosur gjobë, po për këtë lot është tërhequr edhe në pika të tjera dhe janë vendur gjoba në subjekte të ndryshme. Për shkak të parimit “një shkelje një gjobë” dhe për shkak të një pune jo të koordinuar të institucioneve të cilat mbulojnë në këtë formë vetëm një segment të caktuar dhe kufizohen në varitete të ndryshme të farnave, e shohim të arsyeshme t'ju kërkojmë të merrni në konsideratë një linjë tjetër veprimi.

Propozojmë që të merret mostra dhe mos të jepet udhëzimi që pas gjumimit të lotit të shkohet në të gjitha njësitë e tjera duke u pasuar me gjoba tek secili, por ti lihet mundësi verifikimi subjektit importues së pari për të kryer rianalizimin në një subject të licensuar dhe që njihet nga autoritetet vendore. Kjo procedurë do të shmangte gjoba të shumëfishta për të njëjtën shkelje, duke sjelle edhe probleme në marrëdhëniet financiare të bizneseve ndërmjet tyre, duke sjellë një klimë jo të mirë biznesi, dhe jo më pak e rëndësishme është edhe optimizimi i punës së institucioneve shtetërore përgjegjëse për të kryer një mbulim më të gjerë të kontrolleve në varietete të ndryshme.

MBZHR lidhur me kete koment sqaron se është pranuar dhe sqaruar pjesërisht.

American hemp ka shprehur këto komente: 1. Komisioni Evropian ka paraqitur një propozim për të rishikuar ekzistuesin nëpërmjet një rregulloreje legjislatore për prodhimin dhe tregtimin e materialit 1 të re mbi “ riprodhues të materialit bimor” dhe tregtimin të materialit riprodhues 2. Objektivi parësor i bimor” kjo reformë synon të konsolidojë dhjetë direktiva të veçanta dhe të promovojë qëndrueshmërinë, produktivitetin dhe diversifikimin e bujqësisë. Kjo nismë përputhet me qëllimin e Bashkimit Evropian për t'u bërë kontinenti i parë neutral ndaj klimës, siç përshkruhet në Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane 3 se cili kërpi industrial 4 është një pjesë jetike. Është e rëndësishme të theksohet se një here miratohet rregullorja e propozuar e BE-së, LIGJI aktual Nr.10 416 dhe ndryshimet e propozuara të tij nuk do të jenë në përputhje me rregulloren e re të BE-së.

MBZHR sqaron se nuk janë marrë në konsideratë komentet pasi sugjerimet i referohen draft rregullores së BE-së e cila nuk ka hyrë akoma në fuqi dhe nuk mund të merren për referencë pa hyrë në fuqi.

2. Neni 11 pika 5: Konfliktet me nenin 11 pika 1 ishin pasi fermerët dhe kompanitë mund të marrin Licencë për Prodhimin dhe Tregtimin e Farave dhe Fidanëve por nuk lejohen të tregtojnë farëradhe fidane. Shumë fermerë dhe kompani të cilat kanë marrë tashmë një Licencë për Prodhimi dhe Tregtimi i Farave dhe Fidanëve nuk kanë dhe as mund të përballojnë një drejtues teknik të punësuar me kohë të plotë me diplomë bachelor ose master në agronomi.

MBZHR për këtë koment sqaron se nuk pranohet dhe sqaron se për sa i përket detyrimeve jashtë fushës së përgjegjësisë të këtij projektligji nuk mund të merren në konsideratë shkëmbimi I farërave midis fermerëve pasi duhet të zbatohen detyrimet që rrjedhin nga ligji 61/2023, dhe sqarojmë se autorizimet do të jepen pasi kjo bimë është në vëmendje të veçantë dhe është objekt kontrolli dhe i institucioneve që nuk është MBZHR përgjegjëse.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e opsionit të preferuar janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:

- Autoritetin Kompetent për Inspektimin e Ushqimit dhe të Ushqimit për Kafshë;
- Autoriteti Kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve;
- Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe;
- Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të politikës për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor. Kjo bëhet përmes disa masave specifike, si raportimet e AKU-së dhe Autoritetit Kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve, të dhënave të organeve tatimore dhe raporteve të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB).

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Në kuadër të hartimit të legjislacionit, politikave dhe strategjive Ministria e Bujqësisë ka në vëmendje të veçantë *materialin mbjellës dhe shumëzues bimor* i cili konsiderohet si inputi kryesor për bujqësinë, hortikulturën dhe prodhimin e bimëve pyjore si dhe pika e parë e takimit me hallkat e zinxhirit ushqimor dhe garantimit të ushqimit. Çdo hallkë e zinxhirit ushqimor është e përbërë nga një kompleks standardesh, zbatimi dhe kontrolli i të cilëve garanton sigurinë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të përdorur nga fermerët. Sasia e varieteteve, hibrideve për farërat e fidanët që testohen nga ESHFF, si dhe regjistrimi në Katalogun Kombëtar, ka ardhur në rritje. Kjo rritje është bërë kryesisht, bazuar dhe në prioritetet e politikave nxitëse, për fermerët, përmes skemave të mbështetjes kombëtare për prodhimin dhe mbjelljen e fidanëve.

Për këtë qëllim MBZHR, angazhohet të ndërmarrë masa vet apo në bashkëpunim me instancat e tjera të pushtetit për sigurimin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ndërmarrja e veprimeve klimatike, nëpërmjet menaxhimit më të mirë të pyjeve dhe ujërave dhe aplikimit të metodave të prodhimit bujqësor, duke mbrojtur mjedisin dhe zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike, rritjes së numrit të fermave organike të certifikuara dhe rritjes së numrit të fermave që kanë të ardhura jobujqësore.² Mbrojtja e mjedisit është objektiv i të gjithë hallkave të pushtetit shtetëror qendror apo lokal por edhe sepse kjo për bujqësinë ka një rëndësi të vecantë e sidomos kur tërësia e elementevë të mjedisit dhe faktorët ekologjikë si

² SBZRP, fq. 6

temperatura, drita, lagështia, toka, lëndët ushqyese etj janë elemente determinues për rritjen e zhvillimin e bujqësisë, konkretisht farave e fidanëve. Për rritjen dhe zhvillimin e fidanëve nevojiten kushtet e favorshme mjedisore si qenie e përbashkët të cilët nuk mund të zëvendësojnë njëri tjetrin.

Kontributi i SBZHRP 2021–2027³ në përmbushjen e objektitvave të Qeverisë Shqiptare ndër të cilat është edhe bujqësia, shprehet përmes përcaktimit të një kuadri strategjik me ndërhyrje të programuara në këtë dokument që i shërbejnë përmbushjes së vizionit, objektivave dhe prioritetëve të Qeverisë Shqiptare për bujqësinë, zhvillimin rural dhe peshkimin, të cilat janë parashtruar në programin e saj 2021–2025 e që parashikohen të realizohen me masa të mirëpërcaktuara, përkatësisht: Përmirësimi në vazhdimësi të cilësisë së jetës, promovimit të eliminimit të dallimeve në standardet e jetesës ndërmjet zonave rurale dhe atyre urbane, rritja e eksportit të produkteve bujqësore dhe të peshkimit dhe rritja e vlerës së shtuar në vend nëpërmjet orientimit të investimeve në zgjerimin e zinxhirit të vlerës në përpunimin bujqësor, lehtësimi të blerjes së makinerive dhe të pajisjeve për përpunimin bujqësor, përmirësimi të aksesit në tregjet e reja ndërkombëtare, përmirësimi i standardeve të produkteve bujqësore nëpërmjet mbështetjes të prodhimit organik, dhe futjes të standardeve të cilat lehtësojnë eksportet.⁴

Kuadri ligjor mbi përcaktimin e rregullave për krijimin, riprodhimin, shumëzimin, përpunimin dhe tregtimin e materialit mbjellës bimor në territorin e Republikës së Shqipërisë daton prej vitit 1993, me Ligjin Nr.7659, datë 12.1.1993 "Për farat dhe fidanët, shfuqizuar me ligjin Nr.8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës bimor". Më tej kjo bazë ligjore u shfuqizua nga ligji aktual në fuqi Ligji Nr. 10416, datë 7.4.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", i ndryshuar me Ligjin Nr. 67/2013, datë 14.2.2013; Nr.105/2015, datë 1.10.2015; Nr. 12/2019, datë 5.3.2019. Në këtë moment fillon edhe faza e parë e përshtatjes së legjislacionit kombëtar me një model të një shteti të Bashkimit Evropian, konkretisht atë Slloven, ndërsa aktet nënligjore në zbatim të tij janë përafrim i direktivave të këshillit të BE-së .

Ndryshimet e vitit 2018, të cilat u miratuan me hyrjen në fuqi në vitin 2019, parashikonin ndryshimin e disa neneve të ligjit nr. 10416/2011 dhe riformulimi i nenit 44, i këtij ligji për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, ku u analizuan të gjitha licencat dhe lejet e përfshira në Aneksin 1 dhe 2, të VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar. Ky projektligj u hartuar pas konsultave me grupet e interesit kryesisht Entin Shtetëror të Farave e Fidanave, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, si dhe subjekteve, "Agroblend", "Arli internacionale", Agrohëlp" dhe "Agroinput-Jazxhi". Gjithashtu në kuadër të reformës së derregullimit, në përfundim të analizës, u arrit në konkluzionin se 23 licenca do të eliminoheshin. Me anë të këtyre ndryshimeve, synohet të arrihet: a) Reduktim i barrierave administrative; b) Liberalizim i tregut; dhe c) përmirësim i mëtejshëm i klimës së biznesit; ç) përcaktimi i rregullav dhe procedurës së marrjes së mostrave, përgatitjes dhe dërgimit të këtyre mostrave për analizë në laboratorin qëndror të farave apo laboratorët rajonal.

Problematikë tjetër ishte se gjatë praktikës e kryerjes së analizave të materialit mbjellës e shumëzues bimor, veçanarisht pas miratimit të ligjit nr. 105/2015 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 10416, datë 7.4.2001 "Për materialin mbjellës e shumëzues bimor", të ndryshuar,

³ Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural Dhe Peshkimit, 2021–2027.

⁴ SBZRP, fq. 5.

inspektorët e AKU-së⁵, kanë hasur vështirësi lidhur me procedurën e marrjes së mostrave, përgatitjes dhe dërgimit të këtyre mostrave për analizë në laboratorin qendror të farave apo laboratorët rajonal. Nga ana tjetër edhe specialistët e laboratorëve, pas miratimit të ligjeve të sipërcituara, (Ligji nr. 10416 datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” të ndryshuar, dhe ligji nr. 105/2015 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 10416, “Për materialin mbjellës e shumëzues bimor”, të ndryshuar,) nuk kishin të përcaktuar metodikën e pranimit të mostrave, rrugën që ndiqet deri në kryerjen e analizave dhe njoftimin e subjektit për rezultatet e tyre. Për këtë arsye, bazuar edhe në sugjerimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes u mor vendimi për të mos hartuar VKM sipas kërkesave të pikës 4 të nenit 44 të ligjit Nr. 10416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës e shumëzues bimor”, të ndryshuar por të ndryshojë dhe të riformulohet i gjithë neni 44 me arsyetimin se kriteret që duhet të plotësojë laboratorit i akredituar nuk mund të përcaktohen me VKM siç është e përcaktuar në pikën 4 të nenit 44 të ligjit, por përcaktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit apo institucion tjetër i pavarur. Projektligji përcaktonte rregulla më të qarta për analizat e materialit mbjellës e shumëzues bimor, kriteret që duhet të plotësojë laboratorit për t’u konsideruar laborator reference dhe të miratuar dhe llojet e analizave që kryejnë këta laboratorë.

Gjithashtu në këto ndryshime u përcaktuan rregulla më të qarta për analizat laboratorike të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, mënyrën e miratimit të laboratorit të referencës, besueshmërinë e analizave të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në laboratorët e miratuar dhe rolin e laboratorit të referencës për efekt verifikimi të saktësisë dhe besueshmërisë së analizave të materialit mbjellës e shumëzues bimorë.

Ndërkaq puna për përputhshmërinë me acquis e BE-së është materializuar sidomos me miratimin e rregulloreve përmes akteve nënligjore (vendime të Këshillit të Ministrave) të cilat kanë përputhshmëri të pjesshme dhe të cilat parashikojnë përcaktime ligjore rregullatore në fushën e materialit mbjellës e shumëzues bimor⁶

Aktualisht, bujqësia dhe sektorët e biznesit agroushqimor japin një kontribut të rëndësishëm në ekonominë kombëtare. Në vitin 2019, prodhimi kryesor përfaqësonte afro 19% të PBB-së dhe 40% të punësimit kombëtar, ndërsa rreth 40% e popullsisë jetonte në zonat rurale, ku shumica e tyre punonin në bujqësi. Vlerësimet e Bankës Botërore tregojnë se bujqësia ushqimore është në mënyrë direkte dhe indirekte përgjegjëse për sigurimin e pothuajse gjysmës së vendeve të punës në mbarë ekonominë në Shqipëri⁷.

Ndërkaq Qeveria në Programin Qeverisës mbështet strategjinë e saj në 5 shtylla ku modernizim për zhvillim të ekonomisë prodhuese, turizmit, energjisë, **bujqësisë**, ekonomisë digjitale, transporteve dhe shërbimeve⁸.

Sot, bujqësia është shndërruar në një prej motorëve kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit. Shqipëria do të shtojë prodhimin, do të rrisë cilësinë dhe certifikimet standarde duke u bërë një aktor gjithmonë e më i rëndësishëm i eksporteve bujqësore. Bujqësia bashkë me investimet në infrastrukturën dhe shërbimet në fshat do të sigurojë mundësinë për të ndërtuar një jetë me

⁵ Përmes këtij ndryshimi u parashikua kalimi i monitorimit dhe detyrave të tjera të inspektimit në fushën e këtij ligji, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

⁶ Shih faqen 14.

⁷ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 366, datë 16.6.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023–2027”

⁸ Programi i Qeverisë fq 3.

mirëqenie në fshatn shqiptar. Pikërisht një nga pikat kyçe të objektivave qeveritarë janë certifikimet e lëshuara në funksion të qëllimit të rritjes maksimale të kontrollit dhe cilësisë të objektit të certifikimit, në rastin tonë materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

Strategjia e Bujqësisë është dokument politik ku janë përmbledhur në mënyrë të detajuar të gjitha planet e Qeverisë, përkatësisht sektorit përgjegjës në fushën e bujqësisë, i cili u hartua në mbështetje të realizimit të synimeve të Qeverisë Shqiptare për të përcaktuar kuadrin strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit agroushqimor në shtatë vjetët, 2021– 2027, për përmbushjen e nevojave reale të aktorëve dhe grupeve të interesit, për të përballuar sfidat afatmesme dhe afatgjata lidhur me sigurimin e ushqimit, rritjes së të ardhurave, efektet e ndryshimit të klimës, ruajtjen e biodiversitetit, për të zhvilluar dhe bërë më konkurruese ekonominë familjare në zonat rurale, bazuar në politika që mbështesin përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, përdorimin eficient të inputeve bujqësore dhe peshkimit, si dhe njohurive bujqësore dhe inovacionit.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si institucion përgjegjës për hartimin e politikave dhe kuadrin rregullator në fushën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor sëbashku me Entin Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve si institucion implemetues si dhe institucione e tjera të ndërlidhura kanë një rol thelbësor në garantimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor. Ligji aktual dhe aktet nënligjore në zbatim të tij mbulojnë të gjithë aktivitetin lidhur me prodhimin certifikimin analizimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të prodhuar në vend si edhe atë të importuar.

Disa akte nënligjore në zbatim të ligjit janë:

➤ Vendime të Këshillit të Ministrave:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 204, dt. 04.03.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Entit Shtetëror të Farërave e Fidanëve”;
2. Vendim Nr. 531, datë 13.6.2013 “Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Komisionit të Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar”;
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 530, dt. 13.06.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit dhe certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të primeve përvec farës”;
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.319, dt. 27.04.2016 “Për përcaktimin e procedurës të metodës së testimit të varieteteve” etj.

➤ Udhëzime

1. Udhëzim Nr. 26, datë 21.10.2024 “Për përcaktimin e sasive të tregtueshme të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces regjistrimi në katalogun kombëtar, sasive të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, që nuk tregtohen, mënyra e etiketimit të mostrave, kushtet për autorizim, si dhe për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për autorizimin e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht ose në proces regjistrimi në katalogun kombëtar”;
2. Udhëzim Nr. 10, datë 26.4.2024 “Për përcaktimin e procedurës për marrjen e mostrave dhe transportin e tyre për kryerjen e analizave në laborator”.

➤ Akte nënligjore të cilat janë përafrime të *acquis* të BE-së janë disa nga direktivat të përafruar në mënyrë të pjeshshme janë të renditura në vijim:

1. Direktiva e Këshillit 2002/54/EC përafruar pjesërisht me aktin nënligjor Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 309, datë 21.5.2014 “Për kriteret e tregtimit, certifikimit dhe testimit të farës së panxharit”;
 2. Direktivë e Këshillit 2002/53/EC, përafruar pjesërisht me aktin nënligjor Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 319, datë 27.4.2016 “ Për përcaktimin e procedurës e të metodës së testimit të varieteteve”;
 3. Direktivë e Këshillit 2002/55/EC, përafruar pjesërisht me aktin nënligjor Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 332, datë 18.4.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e të certifikimit të farave të perimeve”;
 4. Direktivë e Këshillit 2002/56/EC, përafruar pjesërisht me aktin nënligjor Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 574, datë 24.6.2015 “Për kriteret e tregtimit, certifikimit dhe testimit të farës së patates”;
 5. Direktivë e Këshillit 66/401/EEC, përafruar pjesërisht me aktin nënligjor Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 87, datë 30.1.2013 Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit, certifikimit dhe testimit të farave foragjere”;
 6. Direktivë e Këshillit 66/402/EEC, përafruar pjesërisht me aktin nënligjor Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 86, datë 30.1.2013 Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit, certifikimit dhe testimit të varieteteve për farat e drithërave”;
 7. Direktivë e Këshillit 2008/72/EC of July 15, 2008 përafruar pjesërisht me aktin nënligjor Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 530, datë 13.6.2013”;
 8. Direktivë e Këshillit 68/193/EEC përafruar pjesërisht me aktin nënligjor Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 409, datë 8 maj 2013 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të certifikimit të materialeve të shumëzimit vegjetativ të hardhisë”;
 9. Direktivë e Këshillit 2002/55/EEC përafruar pjesërisht me aktin nënligjor Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 332, datë 18.4.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e të certifikimit të farave të perimeve”;
 10. Direktivë e Këshillit 2008/90/EEC përafruar pjesërisht me aktin nënligjor Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 240, datë 27.3.2013“Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore”;
 11. Direktivë e Këshillit 98/56/EEC përafruar pjesërisht me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 523, datë 13.7.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese”;
 12. Direktivën e Këshillit 2002/57/EE Vendim e Këshillit të Ministrave Nr. 875, datë 14.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të certifikimit të farave të bimëve vajore dhe fibrore”.
- *Përshkruani natyrën e problemit*
 - *Identifikoni shkaqet e problemit.*
 - *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
 - *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile qytetarët.*
 - *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*
 - *Përshkruani natyrën e problemit.*
 - *Identifikoni shkaqet e problemit.*

Shkaqet e problematikave janë:

- Mungesa e akteve nënligjore, të cilat nuk janë miratuar ndër vite, krijon pamundësi në zbatimin korrekt të ligjit.
- Mungesa e një autoriteti kompetent i cili do të bënte monitorimin dhe inspektimin si dhe sigurimin e zbatimit të ligjit përmes masave administrative në rastet e shkeljes së dispozitave të caktuara⁹.

Bazuar në kontekstin e projektligjit për materialin mbjellës dhe shumëzues, shkaktohet, problematikat kryesore të evidentuara në zbatimin e ligjit ekzistues dhe pasojat e problematikave janë si më poshtë:

1. Mungesa e harmonizimit me standardet ndërkombëtare

- **Problematika:** Legjislacioni aktual nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke krijuar pengesa në tregtinë dhe përdorimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.
- **Pasojë:** Prodhuesit vendas përballen me vështirësi për të hyrë në tregjet ndërkombëtare dhe për të konkurruar me produkte të tjera në nivel ndërkombëtar.

2. Mbikëqyrje dhe kontroll i dobët

- **Problematika:** Sistemet ekzistuese të mbikëqyrjes dhe kontrollit të cilësisë së materialeve mbjellëse dhe shumëzues janë të dobëta ose joefektive. Aktualisht, nuk janë të përcaktuara qartë kërkesat për rianalizim të fuqisë mbirëse të materialeve mbjellëse dhe procedurat për certifikimin zyrtar.
- **Pasojë:** Mungesa e rregullimit të tillë çon në një mbikëqyrje të pamjaftueshme të cilësisë së materialeve në treg dhe uljen e besimit të konsumatorëve.

Në treg qarkullojnë produkte me cilësi të ulët, të cilat ndikojnë negativisht në prodhimtarinë bujqësore dhe në besimin e konsumatorëve.

3. Përcaktimet të paqarta ligjore për operatorët dhe përgjegjësitë

- **Problematika:** Ligji aktual nuk përcakton qartë përgjegjësitë e operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve mbikëqyrëse për menaxhimin dhe tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues.
- **Pasojë:** Ka mungesë përgjegjësie dhe llogaridhënieje nga operatorët ekonomikë dhe organet mbikëqyrëse.

4. Mungesa e dokumentacionit gjurmues dhe certifikimit

- **Problematika:** Nuk ekziston një sistem i detajuar dhe i detyrueshëm për gjurmimin dhe certifikimin e origjinës dhe cilësisë së materialeve mbjellëse dhe shumëzues.
- **Pasojë:** Fermerët dhe prodhuesit hasin vështirësi për të siguruar inpute bujqësore të sigurta dhe cilësore.

5. Promovimi i kufizuar i përdorimit të materialit autokton dhe të qëndrueshëm

- **Problematika:** Politikat ekzistuese nuk mbështesin mjaftueshëm përdorimin e materialeve mbjellëse dhe shumëzues autoktonë dhe të qëndrueshëm.

⁹ Në vitin 2020 u miratua krijimi dhe funksionimi i Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve me VKM Nr. 683, datë 2.9.2020.

- Pasojë: Kjo ka çuar në uljen e biodiversitetit bujqësor dhe në përhapjen e varietetesh të paqëndrueshme në disa rajone.

6. Kornizë ligjore e përditësuar me ritme të ngadalta

- Problematika: Ligji nuk është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme për të reflektuar përparimet shkencore dhe teknologjike në bujqësi.
- Pasojë: Ka një hendek midis zhvillimeve aktuale të sektorit dhe legjislacionit në fuqi.
- Problematikë: Aktualisht, proceset e regjistrimit dhe rinovimit të varieteteve nuk janë tërësisht të dixhitalizuara dhe nuk ofrohet një qasje transparente në informacionin publik, si katalogët e varieteteve.
- Pasojë: Procedurat mbeten komplekse dhe kërkojnë ndërhyrje manuale, duke rritur ngarkesën administrative dhe ulur aksesin e menjëhershëm të palëve të interesuara në informacionin e përditësuar.
- Problematika: Ligji ekzistues nuk adreson në mënyrë efektive potencialin për të rritur konkurrueshmërinë e sektorit dhe për të ndikuar pozitivisht në zhvillimin rural.
- Pasojë: Prodhimi bujqësor dhe zinxhiri i vlerës mbeten të kufizuara në krahasim me kapacitetet e mundshme.

Këto problematika justifikojnë nevojën për ndryshime ligjore që do të rrisin transparencën, cilësinë dhe konkurrueshmërinë në sektorin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

- Janë konstatuar disa dobësi që lidhen me procedurat e regjistrimit të varieteteve të reja, lidhur me paqartësi në saktësimin e kriterëve që duhet të plotësojë një varietet për të plotësuar kushtet për regjistrim. Me ndryshimet e propozuara janë vendosur kriterë rigoroze, të qarta, kushte më të përshtatshme të cilat do të shërbejnë qëllimit të sigurimit të cilësisë por edhe fleksibilitetit të procedurës.
- Lidhur me organizimin dhe funksionimin e komisionit, është vërejtur se parashikimet ligjore aktuale, të përcaktuara përmes vendimeve të Këshillit të Ministrave, kanë krijuar vështirësi të mëdha procedurale, sidomos në rastet e ndryshimeve të përbërjes apo funksioneve të komisionit.
- Detyrat e secilit nga institucionet zbatuese të ligjit nuk kishin përcaktime të qarta dhe që i përgjigjen ndryshimeve që kanë ndodhur si pasojë e zhvillimeve të reja. Me ndryshimet ligjore janë specifikuar qartazi kompetencat e strukturave përkatëse dhe detyrat e secilës prej tyre me mirëfunksionimin e kontrollit dhe monitorimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor që nga prodhimi, tregtimi, si dhe të analizimit të tyre: - Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar në treg të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor; - Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve, për certifikimin e materialit të prodhuar në vend; ESHFF, krahas detyrave të parashikuara në ligjin aktual, kryen edhe analizimin për mostrat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të vendosura në treg, të sjella nga Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg si dhe subjektet private;

Shtrirja e problemit

Problemet e identifikuara të cilësuar më lart, janë të nivelit kombëtar që kanë ndikuar në cilësinë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kjo është reflektuar në certifikimin e në nivele jo të kënaqshme në raport me rritjen e kërkesës së fermerëve për prodhim më të lartë ardhur si pasojë e mosfunksionimit siç duhet i Komisionit duke patur parasysh se ndryshimet në përbërje apo edhe në kompetenca ishin të vështira për t'u materializuar në kohë pasi parashikimi me VKM vështirësonte procesin si shkak i kohës së gjatë që do një akt nënligjor i tillë të ndryshohet. Një tjetër anë e problematikës është mospërcaktimi i qartë i kompetencave të strukturave përkatëse duke krijuar herë pas here ngërç institucional në kryerjen e një procesi të caktuar. Cilësia e materialit mbjellës shumëzues e bimor nuk kishte siguri kaq të lartë sa parashikohet përmes ndryshimeve ligjore të cilat do të realizohen përmes kritereve e kushteve të përshtatshme që do jenë detyrime ligjore. Këto mosfunksionime të të gjithë procesit kanë rezultuar në moszhvillimin sipas pritshmërive të kësaj fushe të bujqësisë. Në fokus të përmirësimit të ligjit janë edhe përcaktimi i mënyra e aplikimit përmes e-albania, afrimi i informacionit grupeve të interesit dhe mbrojtja e të drejtave të fermerit.

Grupet e interesit të prekura nga ky problem janë:

- ✓ *Qeveria* - rritje e të ardhurave, rritje e standarteve bujqësore, avantazh në plotësimin e parakushteve të BE-së, rritje e të ardhurave nga sigurimet shoqërore shëndetësore si rrjedhojë e rritjes së punësimit etj.
- ✓ *Operatorët* - e biznesit që importojnë, eksportojnë, prodhojnë, ruajnë dhe tregtojnë material mbjellës dhe shumëzues bimor, i cili është përgjegjës për t'i siguruar konsumatorit farëra dhe fidanë të certifikuar njëkohësisht të pastër nga ana fitosanitare;
- ✓ *Fermerët* - të cilët janë përgjegjës për zbatimin e masave si dhe respektimin e etiketave zyrtare për mbjelljen e tyre për t'i ofruar konsumatorit produkte të sigurta;
- ✓ *Qytetarët* - konsumatorë të cilët paguajnë për produkte të sigurta dhe cilësore me cmime konkurruese.
- ✓ *Punëmarrësit* - më shumë vende pune do të hapen jo vetëm në fushën e përpunimit dhe tregëtimit të materialit mbjellës shumëzues e bimor por edhe në sektorin e bujqësisë si tërësi.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme

Përmes kësaj nisme synohet të intensifikohet njohja dhe evidentimi i çdo hallke të zinxhirit ushqimor, në funksion të garantimit të shëndetit publik dhe mbrojtjes së interesave të konsumatorit.

Mosformalizimi i tregut ka si shkak marketingun e drejtpërdrejtë nga fermeri te konsumatori që ka ofruar një strategji alternative marketingu për fermerët, duke siguruar të ardhurat e tyre, duke përmbushur, gjithashtu, kërkesën në rritje të konsumatorëve për ushqim lokal. Fermerët shqiptarë janë mësuar t'i shesin herë pas here produktet e tyre direkt te klienti fundor, por kryesisht në mënyrë informale. Një nga arsyet kryesore që ky treg nuk është i zhvilluar sa duhet është mungesa e njohurive, që lidhen me krijimin e biznesit të marketingut të drejtpërdrejtë.

Kjo së bashku me frikën e barrierave të rënda administrative janë ndër arsyet kryesore për zhvillimin e një ekonomie gri në sektorin bujqësor/zinxhirin ushqimor, pasi shumica e fermerëve nuk i regjistrojnë aktivitetet e tyre të marketingut të drejtpërdrejtë, por kufizojnë në këtë mënyrë, gjithashtu, mundësitë e tyre ekonomike, p.sh., shitjen e produkteve të tyre te subjektet turistike, të cilat nga ana e tyre duhet të respektojnë kuadrin e sigurisë ushqimore. Siguria ushqimore mbetet prioritet i qeverisjes në mandatin e dytë, në forcimin e qasjes “*nga ferma në tavolinë*”, jo vetëm për produktet blegtorale, por edhe për produktet bujqësore. Instrumentet e aplikuara gjatë mandatit të parë qeverisës për uljen e nivelit të informalitetit, kanë krijuar premisat për rritjen e kontrollit të origjinës së produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe për të rritur nivelin e sigurisë ushqimore në tregjet bujqësore, blegtorale dhe në industrinë agroushqimore¹⁰. Pikërisht për këtë arsye një nga pikat kyçe të objektivave qeveritarë janë certifikimet e lëshuara në funksion të qëllimit të rritjes maksimale të kontrollit dhe cilësisë të objektit të certifikimit, konkretisht në rastin tonë materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

Nëse i referohemi SBZHRP 2021/2027, fuqia e tregut të brendshëm të një shteti ka tregues, veç të tjerave edhe aftësinë konkurruese e cila nga ana e saj ka të bëjë, sidomos me ofrimin e produkteve me cilësi të lartë. Ekziston një procedurë e mirë organizuar për të kontrolluar materialin mbjellës në të gjithë fazat e tij¹¹.

Pavarësisht se fusha objekt diskutimi është aktualisht e rregulluar më ligjin 10416/2011 Shqipëria, Ministria e Bujqësisë është gjithmonë në kërkim të rritjes së standarteve në fushëveprimin që ajo mbulon përmes propozimit të politikave koherente, të mirëmenduara dhe në shërbim të qëllimit për ofrimin e cilësisë më të mirë të mundshme, më çmime konkurruese dhe efekte positive në ekonominë e vëndit.

Ligji në fuqi nuk është i përafuar me ndonjë rregullore specifike europiane por ka krijuar bazën për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e dispozitave të caktuara të cilat janë pjesërisht përshtatje me këto direktiva. Në këtë kuadër edhe ndryshimet që do të bëhen me politikën e re nuk janë përafrim i ndonjë rregulloreje specifike evropiane pasi në këtë moment është vetëm një draft-rregullore e cila përfshin në një njësi të vetme kuadrin rregullator të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

Siç kemi argumentuar deri më tani, nevoja për ndryshime ka ardhur në funksion të përditësimit të legjislacionit lidhur me eliminimin e burokracisë administrative për funksionimin e Komisionit të Rregjistrimit dhe të procedurës së rregjistrimit, certifikimit, importin si edhe detyrimet e tjera për operatorët ekonomikë që veprojnë në këtë fushë ekonomike. Ndërhyrja e Qeverisë është e nevojshme për krijimin e mundësisë së zhvillimit të mëtejshëm të sektorit të materialit mbjellës dhe shumëzues së bimëve.

Sa sipër, është e nevojshme ndërmarrja e një nisme, e cila të përcaktojë qartë strukturat implementuese dhe funksionet e tyre, si dhe të përmirësojë skemën e certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

Ndërhyrja e Qeverisë është thelbësore në aspektin e përcaktimit, zbatimit dhe kontrollit të standardeve që sigurojnë cilësinë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, duke e konsideruar atë si një hallkë kyçe të zinxhirit ushqimor, me synimin për të eliminuar të metat dhe mangësitë e konstatuara në ligjin aktual.

¹⁰ Programi Qeveritar, fq. 11.

¹¹ SBZHRP 2021/2027”;

Gjatë viteve të fundit ka patur disa ndryshime për sa i përket anës organizative, krijimi i institucioneve inpektuese apo ristrukturimi i tyre në kuadër të miratimit të ligjit të ri për inspektimin në RSH, gjë cila solli dhe zëvendësimin e emërtesave të institucioneve me termin “struktura përgjegjëse”.

Nisur dhe nga fakti që materiali mbjellës dhe shumëzues bimor është objekt i subvencioneve si politikë mbështetëse për një bujqësi të qëndrueshme, nëpërmjet kësaj nisme do të shmangen paqartësitë lidhur me certifikimin e materialit mbjellës, dhe procedurat e importit dhe detyrimet e subjekteve që duhen të plotësojnë përpara se ato të rregjistrohen në Katalogun Kombëtar. Kjo ndërhyrje është në funksion dhe mbështetje të objektivit të qeverisë për të siguruar një nivel të lartë të prodhimit vendas, bujqësisë organike si dhe mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorit nëpërmjet garantimit të sigurisë ushqimore përgjatë të gjithë zinxhirit ushqimor nga ferma në tavolinë.

Me këtë propozim për ndryshim ndahen qartësisht detyrat dhe funksionet për institucionet zbatuese ndërmjet Autoriteti Kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve ; Autoriteti Kompetent për Inspektimin e Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë dhe Entit Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve.

-Saktësohen procedurat lidhur me regjistrimin e varieteteve të reja në mbështetje të një bujqësie të qëndrueshme.

-Përmirësohen procedurat e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor .

Pikërisht adresimi në mënyrën e duhur i çështjeve të evidentuara deri më tani është edhe shkaku i një ndërhyrjeje ndryshuese në ligjin bazë që rregullon këtë fushë dhe për këtë qëllim ky projektligj është parashikuar për t’u miratuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2024 (PPAP), për vitin 2024.

Kjo ndërhyrje synon të adresojë disa aspekte kyçe të administrimit dhe rregullimit të tregut për materialet mbjellëse dhe shumëzuese bimore. Ndërhyrja e qeverisë paraqitet e nevojshme për disa arsye, si më poshtë vijon:

1. Nevoja për përmirësimin e qartësisë dhe eficiencës administrative:

Nëpërmjet kësaj nisme synohet të reduktohet burokracia administrajtive dhe të shpejtohen proceset vendimmarrëse.

2. Sigurimi i standardeve të cilësisë dhe mbikëqyrjes teknike:

Nëpërmjet kësaj nisme synohet vendosja e kërkesave për rianalizim të fuqisë mbirëse të materialeve mbjellëse dhe të përcaktohen procedurat për certifikimin zyrtar në mënyrë që të arrihet përforcimi i mbikëqyrjes cilësore.

3. Harmonizimi me praktikën ndërkombëtare:

Kjo nismë ka si qëllim harmonizimin e legjislacionit aktual me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë referenca ndaj metodikave ndërkombëtare, si ISTA, dhe përfshirjen e elementeve të qarta mbi materialet OMGJ.

4. Garantimin e transparencës dhe digjitalizimit të proceseve:

Nëpërmjet kësaj nisme synohet të sigurohet kalimi i proceseve të regjistrimit dhe rinovimit të varieteteve në platformën e-Albania.

Ndërhyerja e Qeverisë vjen si domosdoshmëri për përcaktimin e qartë të kompetencave mes institucioneve, në mënyrë që të shmanget mbivendosja e përgjegjësive dhe të sigurohet më shumë efikasitet operacional.

Gjithashtu, kjo nismë ka si qëllim ndër të tjera edhe rritjen e integritetit dhe vendosjen e kufizimeve mbi konfliktet e interesit për anëtarët e Komisionit të Regjistrimit të Varieteteve.

Sa më sipër, ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të rregulluar më mirë tregun e materialeve mbjellëse dhe shumëzuese bimore, për të përmirësuar cilësinë dhe sigurinë e këtyre materialeve, dhe për të harmonizuar proceset me standardet ndërkombëtare. Qeveria synon të trajtojë sfidat e burokracisë, mungesës së qartësisë në përgjegjësitë institucionale dhe nevojën për digjitalizim dhe transparencë. Kjo ndërhyrje gjithashtu ndihmon në përmbushjen e standardeve të BE-së për agronominë dhe tregtinë e materialeve bimore.

Lidhja e nismës me Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021–2027

Marrja e kësaj nisme për rregullimin e materialit mbjellës dhe shumues bimor është plotësisht në përputhje me Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021–2027. Strategjia përcakton politikat prioritare, objektivat e përgjithshëm dhe planin e masave për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të sektorëve bujqësorë, ruralë dhe të peshkimit.

Një nga shtyllat kryesore të strategjisë është rritja e konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore shqiptare në tregun e brendshëm por edhe atë europian përmes përmirësimit të cilësisë dhe harmonizimit me standardet ndërkombëtare, çka e bën këtë nismë shumë të rëndësishme.

Roli i iniciativave fiskale:

Një mbështetje e rëndësishme për sektorin bujqësor gjatë viteve të fundit ka qenë implementimi i politikave fiskale stimuluese, të financuara nga Qeveria Shqiptare. Këto masa përfshijnë:

1. Heqja ose reduktimi i TVSH-së për inputet bujqësore, përfshirë plehrat kimike, pesticidet, farërat dhe fidanët.
2. Subvencionet dhe mbështetja financiare direkte, për të orientuar prodhimin drejt kulturave me avantazh konkurrues dhe krahasues.

Referuar statistikave për periudhën 2017–2020, këto politika kanë ndihmuar në:

- Diversifikimin e strukturës së mbjelljeve, duke orientuar prodhimin drejt kulturave me rendiment më të lartë dhe që ofrojnë potencial për eksport.
- Rritjen e të ardhurave për njësi sipërfaqe, duke e bërë bujqësinë një sektor më të qëndrueshëm dhe tërheqës për investime.
- Zhvillimin e kulturave bujqësore që plotësojnë standardet ndërkombëtare, duke siguruar një pozicion më konkurrues në tregjet globale.

Kjo nismë, duke synuar përmirësimin e cilësisë dhe kontrollit të materialeve mbjellëse dhe shumues, do të kontribuojë drejtpërdrejt në realizimin e objektivave strategjike, duke nxitur rritjen e qëndrueshme të sektorit bujqësor dhe mbështetur integrimin e produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Fusha që trajton materialin mbjellës shumëzues e bimor është rregulluar me ligjin e posaçëm 10416/2011 dhe akteve të tij nënligjore. Inspektimi dhe monitorimi i zbatimit të ligjit në terren për materialin mbjellës shumëzues e bimor kryhet nga AKVMB ndërsa certifikimi kryhet nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve. Gjatë këtyre viteve ESHFF jo vetëm ka realizuar

qëllimin për të cilin është krijuar, por ka mbështetur fermerin shqiptar në prodhimin dhe tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar, duke i dhënë mundësinë atij që të zotërojë potenciale gjenetike dhe njohje ligjore për produktin që prodhon, mbjell dhe tregton. Konkretisht ESHFF është krijuar me VKM Nr. 155, 25.4.2002 dhe ka për objekt të punës organizimin dhe kontrollin e të gjithë veprimtarisë, që zhvillohet për materialin mbjellës, bimor. ESHF kryen këto detyra: a) të kontrollojë kudo ku prodhohet, riprodhohet, shumëzohet, përpunohet e magazinohet, transportohet, eksportohet, importohet dhe tregtohet material mbjellës, bimor; b) të bashkëpunojë me organizmat ndërkombëtarë si motra, të vendeve të tjera në fushën e materialit mbjellës, bimor; c) të bashkëpunojë me institutet kërkimore-shkencore të vendit dhe të jetë bashkërendues i punës së tyre për çvënien në dukje, grumbullimin, studimin dhe ruajtjen e materialeve gjenetike bimore, si dhe me çdo fermer apo subjekt, që ka në pronësi bimë bujqësore, me vlerë gjenetike. ç) Të organizojë, sipas kërkesave, trajnime për marrjen e mostrave, kryerjen e analizave laboratorike të materialit mbjellës, bimor dhe të japë certifikatë trajnimi etj.

Më tej, ESHFF ka kompetencë kryerjen dhe mbikëqyrjen e provave të testimit të varieteteve të reja të bimëve të kultivuara të krijuara në vend ose të ardhura nga vendet e tjera, për vlerën e kultivimit e të përdorimit (VKP) dhe për dallueshmërinë, uniformitetin e stabilitetin (DUS). Provat zyrtare të testimit të varieteteve të bimëve të arave kryhen për: - varietetet e krijuara në vend, në jo më pak se dy vjet; - varietetet që përfshihen në regjistrin e OECD-së, në jo më pak se një vit, dhe, pas kualifikimit ato përfshihen në katalogun zyrtar; - varietetet e regjistruara në vendet e tjera, por që nuk përfshihen në regjistrin e OECD-së, në jo më pak se një vit dhe vetëm për vlerën e kultivimit e të përdorimit (VKP); - varietetet e bimëve drufrutore, në jo më pak se dy vjet pas hyrjes së tyre në prodhim. Kryerja e provave zyrtare të testimit të varieteteve të bimëve të kultivuara realizohet, në jo më pak se dy zona që përfaqësojnë kushte të ndryshme klimatike. Zonat ku do të kryhen provat zyrtare të testimit të varieteteve janë: Tirana, Shkodra, Dibra, Korça, Lushnjë dhe Vlora.” b) Shkronja “e” ndryshohet si më poshtë vijon: “e) Botimin e katalogut zyrtar të specieve dhe varieteteve të bimëve të kultivuara çdo vit, brenda muajit shkurt. Ndryshimet që bëhen gjatë vitit publikohen, periodikisht, nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve.”

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Politika e propozuar synon realizimin e objektivave si më poshtë:

1. Efektiviteti në rritjen e eksporteve nëpërmjet garantimit të cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të vendosur në treg brenda me 15% brenda vitit 2030;
2. Efektiviteti i mekanizmave të vendosur për rritjen e numrit të certifikimeve të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me 20% brenda vitit 2029;
3. Plotësimi i legjislacionit në fushën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me akte nënligjore përmes të cilave do të bëhet i mundur zbatimi i rregullave dhe kriterëve të reja ligjore të parashikuara me këtë projektligji brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e projektligjit;
4. Efektiviteti i procedurave më të thjeshta për regjistrimin e varieteteve të reja të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në Katalogun Kombëtar pas hyrjes në fuqi të këtij projektakti.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës së kryer, janë shqyrtuar 4 opsione:

Opsioni 0 (*status quo*): Mosndërhyrja me ligj të ri; Ky opsion do të thotë të vijohet të mbeten problematikat aktuale duke mos adresuar zgjidhjen e tyre. Ligji Nr. 10416 datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” të ndryshuar.

Ky opsion paraqet disa avantazhe dhe disavantazhe si më poshtë vijon:

Avantazhet:

Kostot e ulëta administrative dhe ligjore:

Ruajtja e ligjit ekzistues shmang nevojën për shpenzime të reja për hartimin dhe miratimin e një ligji të ri.

Mosndryshimi i ligjit eliminon vonesat dhe sfidat që lidhen me adaptimin e kuadrit të ri ligjor dhe operacional.

Disavantazhet:

Problemet e evidentuara në zbatimin e ligjit aktual, si mungesa e kontrollit efektiv, standardeve të qarta dhe koordinimit institucional, nuk adresohen, duke çuar në uljen e cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues në treg.

Në mungesë të rregullimeve të nevojshme, situata mund të përkeqësohet, duke ndikuar negativisht në bujqësinë dhe në aftësinë konkurruese të vendit në tregjet ndërkombëtare.

Vazhdimi i status quo-së nënkupton mosarmonizimin me standardet dhe praktikën e Bashkimit Evropian, gjë që pengon zhvillimin dhe aksesin në tregjet evropiane.

Ligji aktual nuk ofron kuadrin e duhur për mbështetjen dhe zhvillimin e bujqësisë organike, duke kufizuar potencialin e saj të rritjes.

Në përmbledhje, ndërsa mosndërhyrja mund të jetë më e lehtë dhe më e shpejtë në afat të shkurtër, disavantazhet e saj e tejkalojnë ndjeshëm çdo përfitim të mundshëm, duke e bërë këtë opsion të papërshtatshëm për zgjidhjen e problematikave aktuale.

Opsioni 1: Kryerja e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin aktual në fuqi.

Ky opsion konsiston në kryerjen e shtesave dhe ndryshimeve në Ligjin Nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor,” për të adresuar problemet e hasura gjatë zbatimit të tij. Synohet eliminimi i mangësive aktuale dhe përshtatja e ligjit me kërkesat e reja dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE).

Avantazhet e opsionit:

1. Zgjidhje më e shpejtë dhe më pak e kushtueshme: Ndryshimet në ligjin ekzistues kërkojnë më pak kohë dhe burime financiare sesa hartimi i një ligji të ri.
2. Amendimet mund të ndihmojnë në harmonizimin e kuadrit ligjor me draft-rregulloren e re të BE-së, e cila pritet të zëvendësojë disa direktiva ekzistuese.

3. Konsolidim i kornizës organizative dhe funksionale: Përditësimi i strukturave dhe përfshirja e emërtesave të reja sipas ligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” e bën më të qartë dhe efektiv implementimin e dispozitave.
4. Ky opsion përgatit terrenin për një tranzicion më të lehtë drejt legjislacionit të ri të BE-së, kur ai të miratohet.

Disavantazhet e opsionit:

1. Zgjidhje afatshkurtër: Ndryshimet e propozuara nuk e transformojnë tërësisht ligjin, duke e bërë këtë opsion një zgjidhje të përkohshme deri në miratimin e një rregulloreje të re të BE-së.
2. Amendimet mund të shtojnë kompleksitetin e ligjit ekzistues, duke krijuar potencial për pasiguri në interpretim dhe zbatim.
3. Ligji aktual mund të mos përfshijë plotësisht të gjitha dimensionet e kërkuara nga rregullorja e re e BE-së, duke e bërë të nevojshme rishikimin e tij të mëtejshëm në të ardhmen.
4. Meqenëse rregullorja e re është ende në fazë drafti, ekziston një pasiguri mbi afatet dhe përmbajtjen e saj përfundimtare, duke e bërë këtë opsion potencialisht të papërshtatshëm për zhvillime të papritura.

Amendimi i ligjit ekzistues paraqet një qasje pragmatike dhe me kosto të ulët për të adresuar problemet aktuale dhe për të përgatitur strukturat ligjore dhe institucionale për ndryshimet e ardhshme të BE-së. Megjithatë, është një zgjidhje e pjesshme që mund të kërkojë përsëritje të procesit në të ardhmen.

Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

Ky opsion përfshin hartimin e një ligji të ri për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, duke zëvendësuar tërësisht ligjin ekzistues. Qëllimi do të ishte krijimi i një kornize të re dhe më të avancuar ligjore, e përshtatur me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe standardet e Bashkimit Evropian (BE).

Avantazhet e opsionit:

1. Një ligj i ri ofron mundësinë për të rishikuar dhe përshtatur të gjithë kornizën ligjore, duke eliminuar plotësisht çdo pasiguri ose mospërputhje në dispozitat ekzistuese.
2. Një ligj i ri mund të harmonizohet plotësisht me standardet e reja të BE-së, kur rregullorja e saj të miratohet dhe të hyjë në fuqi.
3. Hartimi i një ligji të ri krijon një bazë të qëndrueshme për menaxhimin dhe rregullimin e sektorit në një horizont më të gjatë kohor, duke reduktuar nevojën për ndërhyrje të shpeshta.

Disavantazhet e opsionit:

1. Kosto e lartë: Hartimi i një ligji të ri kërkon më shumë burime financiare dhe njerëzore për zhvillim, konsultime dhe miratim.
2. Zgjatje e procedurave: Procesi për përgatitjen dhe miratimin e një ligji të ri është më i gjatë, çka mund të vonojë adresimin e problemeve aktuale.
3. Mungesa e përputhjes me situatën aktuale: Duke qenë se rregullorja e re e BE-së është ende në fazë drafti, ekziston rreziku që ligji i ri të mos përputhet plotësisht me përmbajtjen dhe kërkesat e saj finale.
4. **Rreziku i përfshirjes së çështjeve të panevojshme:** Hartimi i një ligji të ri mund të prekë edhe fusha ose çështje që nuk kërkojnë ndërhyrje urgjente, duke e bërë procesin më kompleks dhe më pak efektiv.

Hartimi i një ligji të ri për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor është një opsion që garanton zgjidhje afatgjatë dhe gjithëpërfshirëse. Megjithatë, kompleksiteti dhe kostoja e lartë e këtij procesi, së bashku me pasigurinë lidhur me rregulloren e re të BE-së, e bëjnë këtë opsion më pak të favorshëm në kushtet aktuale.

Opsioni 3- Jorregullator - Ky opsion fokusohet në ndërmarrjen e masave jorregulatore, duke inkurajuar operatorët ekonomikë të adoptojnë praktika të mira për sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me standardet. Në këtë kontekst, mund të krijohen programe edukimi, fushata ndërgjegjësimi dhe udhëzime teknike për operatorët që ofrojnë materiale mbjellëse dhe shumëzuese bimor. Gjithashtu, mund të promovohet vetë-rregullimi përmes kodeve të sjelljes dhe standardeve vullnetare të sektorit.

Avantazhet e opsionit:

1. Kosto më të ulëta: Nuk kërkon shpenzime të konsiderueshme për ndryshime ligjore ose procedurale dhe mund të implementohet me fonde ekzistuese për fushata informuese dhe trajnime.
2. Operatorët ekonomikë mund të përshtasin praktikën sipas nevojave dhe burimeve të tyre, duke mos qenë të detyruar nga dispozita ligjore specifike.
3. Edukimi dhe ndërgjegjësimi ndihmojnë në ngritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve në mënyrë të qëndrueshme, duke ndërtuar një kulturë të cilësisë në treg.
4. Operatorët janë të lirë të aplikojnë praktika të avancuara dhe zgjidhje teknologjike për të përmirësuar produktet e tyre pa kufizime ligjore.
5. Fokusi në vetë-rregullim mund të krijojë mundësi bashkëpunimi mes sektorit privat dhe institucioneve përmes iniciativave vullnetare.

Disavantazhet e opsionit:

1. Mungesë detyrueshmërie: Pa një bazë ligjore detyruese, jo të gjithë operatorët do të ndjekin praktikën e rekomanduar, duke lënë hapësirë për mospërputhje dhe abuzime.
2. Ndryshimet në sjellje dhe standarde mund të ndodhin me ritme të ngadalta, duke mos adresuar problemet urgjente.
3. Monitorim i kufizuar: Institucionet publike kanë më pak mjete për të mbikëqyrur përputhshmërinë me standardet dhe për të ndërhyrë në rastet e mospërputhjes.
4. Operatorët më të vegjël ose më pak të organizuar mund të mos kenë kapacitetet për të ndjekur udhëzimet, duke krijuar një hendek në cilësinë e produkteve të ofruara në treg.
5. Në rast të emergjencave ose krizave, mungesa e një kornize ligjore të qartë mund të vonojë reagimin e shtetit.

Opsioni jorregullator i edukimit dhe vetë-rregullimit është një qasje fleksibile dhe e leverdishme për të nisur përmirësime në treg pa ndryshuar menjëherë ligjin. Megjithatë, për të garantuar përputhshmëri dhe cilësi uniforme në nivel kombëtar, mund të jetë e nevojshme plotësimi i tij me masa rregulatore në të ardhmen.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*

- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Identifikoni se kush preket

Grupet e interesit që preken janë:

- ✓ *Qeveria* - rritje e të ardhurave, rritje e standarteve bujqësore, avantazh në plotësimin e parakushteve të BE-së, rritje e të ardhurave nga sigurimet shoqërore shëndetësore si rrjedhojë e rritjes së punësimit etj.
- ✓ *Operatorët* - e biznesit që importojnë, eksportojnë, prodhojnë, ruajnë dhe tregtojnë material mbjellës dhe shumëzues bimor, i cili është përgjegjës për t'i siguruar konsumatorit farëra dhe fidanë të certifikuar njëkohësisht të pastër nga ana fitosanitare;
- ✓ *Fermerët* - të cilët janë përgjegjës për zbatimin e masave si dhe respektimin e etiketave zyrtare për mbjelljen e tyre për t'i ofruar konsumatorit produkte të sigurta;
- ✓ *Qytetarët* - konsumatorë të cilët paguajnë për produkte të sigurta dhe cilësore me cmime konkurruese.
- ✓ *Punëmarrësit* - më shumë vende pune do të hapen jo vetëm në fushën e përpunimit dhe tregëtimit të materialit mbjellës shumëzues e bimor por edhe në sektorin e bujqësisë si tërësi.

Ndikimet e ndryshimeve të propozuara sipas grupeve të prekura:

1. Struktura përgjegjëse për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor në MBZHR:

- Përgjegjësi të shtuara: Riorganizimi i detyrave për të siguruar zbatimin e kuadrit ligjor të përditësuar dhe përmirësimin e cilësisë së materialeve mbjellëse në treg.
- Rritja e kapaciteteve: Kërkohen burime shtesë për trajnime të personelit dhe për mbikëqyrje më të hollësishme të operatorëve ekonomikë.

2. Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve (ESHFF):

- Përmirësimi i procedurave të certifikimit dhe kontrolleve të cilësisë kërkon pajisje laboratorike më moderne dhe trajnime për personelin.
- Rritja e transparencës: Pritet të zhvillohen protokolle më të qarta për inspektimet dhe komunikimin me operatorët ekonomikë.
- Raportime të shtuara: Krijimi i bazave të dhënash më të plota për materialet mbjellëse dhe shumëzuese.

3. Autoriteti Kompetent për Inspektimin e Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë:

- Zgjerimi i përgjegjësiave për monitorimin e sigurisë dhe standardeve të materialeve mbjellëse që përdoren në prodhim.
- Procedura të përmirësuara për ndjekjen e origjinës dhe cilësisë së materialeve mbjellëse në tregtinë ndërkombëtare.

4. Autoriteti Kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjes e Bimëve :

- Përmirësimi i masave mbrojtëse: Ndryshimet pritet të forcojnë kontrollin ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve përmes rregulloreve më strikte për materialin mbjellës.
- Kapacitete shtesë për inspektime: Nëpërmjet këtij opsioni parashikohet të kërkohej rritje e burimeve për të përballuar fluksin e kontrolleve dhe inspektimeve në terren.

5. Operatorët e biznesit që importojnë, eksportojnë, prodhojnë, ruajnë dhe tregtojnë material mbjellës dhe shumëzues bimor:

- Operatorët duhet të investojnë në dokumentacion shtesë, certifikata cilësie dhe teknologji për të përmbushur standardet e përditësuara.
- Rritja e konkurrencës: Përmirësimi i cilësisë mund të sjellë avantazhe tregtare për ata që arrijnë të përshtaten më shpejt.
- Kërkesat e reja mund të rrisin shpenzimet e operatorëve, por potencialisht edhe përfitimet afatgjata.

6. Fermerët:

- Qasje në materiale cilësore: Përmirësimi i standardeve për materialet mbjellëse pritet të ndikojë pozitivisht në produktivitetin dhe cilësinë e prodhimit.
- Rritja e ndërgjegjësimit: Fermerët do të përfitojnë nga trajnime dhe fushata ndërgjegjëse mbi përdorimin e materialeve të certifikuara dhe të sigurta.
- Materialet e certifikuara mund të jenë më të kushtueshme, por me përfitime më të mëdha në rendiment.

7. Konsumatorët:

- Rritja e standardeve për materialet mbjellëse do të ndikojë në cilësinë e produkteve bujqësore që konsumojnë.
- Ndikimi indirekt në çmime: Përmirësimet në cilësi mund të sjellin rritje të lehtë të çmimeve në tregun e produkteve ushqimore.
- Përfitime afatgjata: Produktet më cilësore dhe më të sigurta ndihmojnë në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së konsumatorëve.

8. Punëmarrësit

- Më shumë vende pune do të hapen jo vetëm në fushën e përpunimit dhe tregëtimit të nënprodukteve me origjinë joshtazore por edhe nësektorin e bujqësisë si tërësi.

Ndikim kryesor dhe i drejtëpërdrejtë për të gjitha grupet e prekura është rritja e të ardhurave të tyre. Konkretisht fermerët garantojnë të ardhurat e tyre nga aktiviteti i me materialin mbjellës shumëzues bimor, tregtarët i shesin më shpejt mallrat/produktet dhe i arkëtojnë më shpejt të hyrat, po ashtu krijimi i një tregu të ri, me çmime më të përtatshme, ku edhe shteti arkëton më shumë të hyra nga intensifikimi i tregëtisë së produkteve të sigurta, përmirësimi i jetës në komunitetet e banorëve në zonat rurale etj.

Në mënyrë të përmbledhur ndikimet Ekonomike, Financiare, Sociale dhe Mjedisore, parashikohen si më poshtë:

Pozitive

Ekonomike:

- Rritja e formalizimit të tregut të materialeve mbjellëse dhe shumëzuese bimor.
- Lehtësi për bizneset me eliminimin e disa hapave burokratikë, duke ulur kostot administrative.
- Mbështetje për eksportuesit përmes standardizimit të produkteve në përputhje me rregullat e BE-së dhe UPOV-it;
- Rritje e nivelit të eksporteve për produktet vendase;
- Rritja e investimeve në sektorin e materialeve mbjellëse dhe shumëzuese;
- Hapja dhe nxitja e tregtisë së produkteve në tregjet ndërkombëtare.

Financiare:

- Ulja e kostove për furnizuesit që ndjekin standardet dhe plotësojnë kërkesat e regjistrimit.
- Reduktimi i ngarkesës financiare të qeverisë për menaxhimin e katalogëve dhe kontrolleve përmes delegimit të detyrave.

Sociale:

- Rritja e sigurisë për konsumatorët dhe fermerët që përdorin materiale të kontrolluara dhe të certifikuara.
- Transparencë më e madhe përmes publikimeve online të katalogëve dhe informacioneve për tregun.

Mjedisore:

- Promovimi i përdorimit të materialeve të cilësisë së lartë, që mund të përmirësojnë efikasitetin e përdorimit të tokës dhe burimeve natyrore.
- Mbikëqyrja e varieteteve OMGJ për të shmangur ndikimet negative mjedisore.

Ekonomike:

- Rritja e përgjegjësisë për furnizuesit, siç është analiza e fuqisë mbirëse çdo 6 muaj, mund të rrisë kostot e operimit.
- Kufizimi i tregut për individë apo biznese që nuk arrijnë të përmbushin kërkesat e reja ligjore.

Financiare:

- Shpenzime shtesë për laboratorët dhe institucionet përgjegjëse për kontrollet dhe analizat e materialeve.

Sociale:

- Kufizime për disa prodhues dhe tregtarë që nuk plotësojnë kriteret, çka mund të shkaktojë ankesa ose rezistencë nga grupet e prekura.

Mjedisore:

- Nëse kontrollet dhe certifikimet nuk zbatohen siç duhet, mund të ketë ndikime negative nga përdorimi i varieteteve jo të sigurta.

Aktualisht është e pamundur të kryhet një analizë sasiore në terma monetarë e kostove, pasi mungojnë të dhëna të detajuara për koston e implementimit të ndryshimeve të propozuara, si për institucionet përgjegjëse ashtu edhe për operatorët ekonomikë.

Faktorë të tillë si ndryshimet në tregun global, kushtet ekonomike të vendit, apo zhvillimet e tjera të lidhura me bujqësinë dhe tregtinë mund të ndikojnë në analizën financiare dhe janë të paparashikueshme në këtë moment.

Gjithashtu, pamundësia për kryerjen e një analize sasiore financiare në këtë moment për shkak të varësisë nga faktorë specifikë:

1. Varësia nga numri i bizneseve dhe operatorëve të përfshirë:

Aktualisht mungon një vlerësim i saktë i numrit të bizneseve dhe operatorëve që do të përfshihen në këtë fushë, si ata që importojnë, eksportojnë, prodhojnë, ruajnë, apo tregtojnë material mbjellës dhe shumëzues bimor.

Pa një regjistër të qartë të këtyre subjekteve, është e pamundur të përllogariten ndikimet financiare në shkallë të gjerë.

2. Varësia nga lloji i teknologjisë së përdorur:

Kostot financiare lidhen drejtpërdrejt me llojin e teknologjisë që do të përdoret nga bizneset për të përmbushur standardet e reja. Nuk është përcaktuar ende nëse operatorët duhet të investojnë në teknologji të avancuar, dhe këto shpenzime mund të ndryshojnë ndjeshëm bazuar në natyrën dhe shkallën e operacioneve të tyre.

3. Varësia nga sasia e materialit të përpunuar ose tregtuar:

Kostot financiare të operatorëve dhe ndikimi ekonomik varet nga sasia e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor që ata trajtojnë. Pa të dhëna mbi vëllimet aktuale dhe të pritshme të materialit, është e pamundur të projektohet ndikimi financiar me saktësi.

4. Heterogjeniteti i aktiviteteve të biznesit:

Bizneset që operojnë në këtë fushë mund të kenë aktivitete shumë të ndryshme, duke përfshirë prodhimin lokal, importin, eksportin dhe ruajtjen. Çdo aktivitet ka struktura të ndryshme kostosh dhe ndikimesh financiare, duke e bërë të vështirë të bëhet një analizë sasiore uniforme.

5. Ndryshimet potenciale në shpenzimet administrative dhe operacionale:

Shpenzimet e implementimit për institucione si Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve apo Autoriteti Kombëtar i Ushqimit do të varen nga burimet njerëzore dhe logjistike që do të jenë të nevojshme. Gjithashtu, këto shpenzime mund të ndryshojnë bazuar në vendimin për ngritjen e laboratorëve të rinj, blerjen e pajisjeve, apo trajnimin e stafit.

6. Mungesa e parashikimit për ndryshimet në kërkesë dhe ofertë:

Ndikimi në tregun vendas dhe ndërkombëtar, si dhe në sjelljen e konsumatorëve dhe fermerëve, mbetet i paparashikueshëm. Pa të dhëna të qarta për këto ndryshime, nuk mund të vlerësohen efektet financiare mbi të gjitha palët e interesuara.

Varësia nga faktorë të tillë si numri i operatorëve të përfshirë, lloji i teknologjisë që do të përdoret, sasia e materialit të përpunuar dhe ndryshimet në treg, e bëjnë të pamundur realizimin e një analize sasore financiare në këtë moment. Këto elemente kërkojnë mbledhje të dhënash, studime dhe konsultime më të thelluara për të siguruar një analizë të besueshme.

Për të realizuar një analizë sasore të saktë dhe të besueshme, do të nevojitet kohë për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit, përmirësimin e kuadrit rregullator dhe përfshirjen e ekspertëve financiarë dhe teknikë dhe këto kosto do të mund të përlogariten dhe përcaktohen nëpërmjet akteve nënligjore që do të miratohen në një moment të dytë, pas miratimit të projektligjit.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsionet që merren në konsideratë janë:

- Opsioni 0 (status quo): Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re;
- Opsioni 1: Rishikimi i bazës ligjore ekzistuese
- Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri.
- Opsioni 3 (jorregullator)

Opsioni i preferuar është përzgjedhur opsioni 1, i cili ka si qëllim realizimin e ndryshimeve ligjore përmes të cilave do të përcaktohen kompetencat në mënyrë definitive të institucioneve përgjegjëse sipas fushës së përcaktuar që mbulojnë duke përmbushur detyrimin për ndjekjen e të gjitha hallkave nëpër të cilat kalon procesi i trajtimit të materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.

Konkretisht ky projektligj, ka përmirësuar strukturat, procedurën dhe kërkesat për regjistrimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në katalogun kombëtar: - është përcaktuar se aplikimi për regjistrimin kryhet në sistemin on-line në platformën ndërqeveritare e-albania, duke saktësuar dhe dokumentacionin e kërkuar; - janë cituar më qartë dhe thjeshtë kushtet që duhet të plotësojë një varietet për t'u regjistruar në Katalogun Kombëtar; - ka përcaktuar rolin dhe funksionin e Komisionit të Regjistrimit të Varieteteve (KRV), si organ kolegjal teknik, i përhershëm dhe vendimmarrës, i cili funksionon në mënyrë periodike në procedurën e regjistrimit të varieteteve; - rregullon ofrimin e informacionit për grupet e interesit, institucionet zyrtare të kontrollit si dhe për fermerët apo palë të tjera të interesuara, nëpërmjet publikimit të Katalogut Kombëtar në faqen zyrtare të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe të Ministrisë si dhe përditësimin sa herë që pëson ndryshime.

Shkaku i problemit janë pikërisht pengesat proceduriale lidhur me llojet e akteve nënligjore

miratuese që parasheh ligji në fuqi, paqartësitë në ndarjen e kompetencave mes institucioneve zbatuese dhe burokracia administrative lidhur me procese të rëndësishme si procedurat e regjistrimit të varieteteve në katalogun kombëtar, organizimin e strukturave dhe përfshirja e plotë e tyre sipas fushës së përgjegjësisë, vështirësitë që paraqesin miratimi i akteve nënligjore (VKM) sipas parashikimeve të ligjit aktual në fuqi.

- Ndryshimet që propozohen fokusohen në: ndryshimin e akteve nënligjore miratuese procedurale në urdhëra të Ministrit, sipas ligjit, pjesa më e madhe e të cilave aktualisht parashikohen për t'u miratuar me vendime të Këshillit të Ministrave, ndërkohë që janë të natyrës teknike si dhe nuk impaktojnë institucione të ndryshme nga MBZHR, identifikuar si faktor që ndikon në vështirësimin e përditësimit me risitë që sjell zhvillimi i sektorit por edhe politika me orientim nga BE.

- Ndahen qartësisht detyrat dhe funksionet për instiucionet zbatuese ndërmjet Autoriteti Kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve ; Autoriteti Kompetent për Inspektimin e Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë dhe Entit Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve.

-Saktësohen procedurat lidhur me regjistrimin e varieteteve të reja në mbështetje të një bujqësie të qëndrueshme.

-Përmirësohen procedurat e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor .

Gjithashtu, Ndryshimet në ligjin ekzistues kërkojnë më pak kohë dhe burime financiare sesa hartimi i një ligji të ri. Përditësimi i strukturave dhe përfshirja e emërtesave të reja sipas ligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” e bën më të qartë dhe efektiv implementimin e dispozitave.

Pikërisht adresimi në mënyrën e duhur i çështjeve të evidentuara deri më tani është edhe shkak i një ndërhyrjeje ndryshuese në ligjin bazë që rregullon këtë fushë dhe për këtë qëllim ky projektligj është parashikuar për t'u miratuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2024 (PPAP), për vitin 2024. Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, janë ndjekur hapat e mëposhtme:

1. Efektiviteti në rritjen e eksporteve nëpërmjet garantimit të cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të vendosur në treg brenda me 15% brenda 5 vitesh nga hyrja në fuqi e projektligjit.
2. Efektiviteti i mekanizmave të vendosur për rritjen e numrit të certifikimeve të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me 20% brenda vitit 2029..
3. Plotësimi i legjislacionit në fushën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me akte nënligjore përmes të cilave do të bëhet i mundur zbatimi i rregullave dhe kritereve të reja ligjore të parashikuara me këtë projektligji.
4. Efektiviteti i procedurave më të thjeshta për regjistrimin e varieteteve të reja të Materialit Mbjellës dhe Shumëzues Bimor në Katalogun Kombëtar pas hyrjes në fuqi të këtij projektakti.
5. Kosto-efektiviteti

Vendosja e peshës së kritereve sipas rëndësisë relative;

1. Efektiviteti në rritjen e eksporteve nëpërmjet garantimit të cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të vendosur në treg brenda me 15% brenda vitit 2030 -5
2. Efektiviteti i mekanizmave të vendosur për rritjen e numrit të certifikimeve të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me 20% brenda vitit 2029.- 3

3. Plotësimi i legjislationit në fushën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me akte nënligjore përmes të cilave do të bëhet i mundur zbatimi i rregullave dhe kritereve të reja ligjore të parashikuara me këtë projektligji brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e projektligjit-4
4. Efektiviteti i procedurave më të thjeshta për regjistrimin e variteteve të reja të Materialit Mbjeles dhe Shumëzues Bimor në Katalogun Kombëtar pas hyrjes në fuqi të këtij projektakti - 4
5. Kosto-efektiviteti-5

III. Përcaktimi i shkallës së performancës nëpërmjet intervalit të pikëve nga 0 – 5.

IV. Pikëzimi përkundrejt secilit kriter sipas matricës së mëposhtme.

Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1		Opsioni 2		Opsioni 3	
		Pikë	Vlera (= Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
Efektiviteti i rritjes së eksporteve nëpërmjet garantimit të cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të vendosur në treg brenda me 15% brenda vitit 2030.	5	2	10	5	25	5	25	3	15
Efektiviteti i mekanizmave të vendosur për rritjen e numrit të certifikimeve të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me 20% brenda vitit 2029.	3	1	3	4	12	4	12	2	6
Plotësimi i legjislationit në fushën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me akte nënligjore përmes të cilave do të	4	1	4	5	20	4	16	1	4

bëhet i mundur zbatimi i rregullave dhe kriterëve të reja ligjore të parashikuara me këtë projektligji brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e projektligjit.									
Efektiviteti i procedurave më të thjeshta për regjistrimin e varieteteve të reja të Materialit Mbjellës dhe Shumëzues Bimor në Katalogun Kombëtar pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji.	4	1	4	5	20	3	12	2	8
Kostot efektiviteti	5	1	5	4	20	5	25	3	15
Pikët totale për secilin opcion		26		97		90		48	

Analiza me shumë kriterë tregon se opsioni 1 (ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji Nr. 10416 datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” të ndryshuar”) është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si opsionin tonë të preferuar.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e opsionit të preferuar janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:

- Autoritetin Kompetent për Inspektimin e Ushqimit dhe të Ushqimit për Kafshë;
- Autoriteti Kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve;
- Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe;
- Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore.

Pengesa të mundshme gjatë zbatimit të opsionit të preferuar, miratimi jo në kohë i akteve nënligjore e lidhur kjo ngushtësisht edhe me reformën e inspektoriateve me miratimin e Ligjit Nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i cili parasheh bashkimin e

inspektoriateve të AKU-së dhe AKVMB-së nën kupolën e përbashkët të një inspektoriatit të vetëm sipas këtij ligji.

Gjithashtu, disa pengesa të tjera të mundshme që mund të lindin gjatë zbatimit të opsionit të preferuar janë:

- Institucionet përgjegjëse, si Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, Autoriteti Kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve, Autoriteti Kompetent për Inspektimin e Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë mund të përballen me mungesë të burimeve njerëzore dhe infrastrukturore për të përmbushur detyrimet e reja.
- Mungesa e pajisjeve laboratorike të përshtatshme dhe e trajnimeve specifike për stafin mund të ngadalësojë procesin e certifikimit dhe kontrollit të cilësisë.
- Rezistenca nga operatorët ekonomikë:
- Bizneset që merren me prodhimin, importin dhe tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor mund të përballen me kosto shtesë për përmbushjen e standardeve të reja. Kjo rezultojë në vonesa për të zbatuar kërkesat e reja ligjore.
- Bashkëpunimi i pamjaftueshëm midis strukturave përgjegjëse për kontrollin dhe certifikimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor mund të shkaktojë mbivendosje të funksioneve ose boshllëqe në zbatimin e përgjegjësisë.
- -Nëse kostot shtesë për përmbushjen e standardeve të reja transferohen te fermerët dhe konsumatorët, mund të rriten çmimet e produkteve bujqësore dhe të bjerë kërkesa për to. Kjo mund të ndikojë negativisht te fermerët e vegjël që nuk mund të përballojnë çmimet më të larta të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar.

Masa të cilat do të merrën për adresimin e risqeve të parashikuara më lart apo për të minimizuar efektet negative janë:

- -Hartimi i një plani zbatimi gjithëpërfshirës që përfshin vlerësimin e rreziqeve;
- -fokusimin vecanërisht në fushat me risk të lartë që do të evidentohen;
- -forcimi i kapaciteteve institucionale, burimet njerëzore dhe teknike;
- -bashkëpunimi i ngushtë me të gjithë aktorët e zinxhirit, institucionet zbatuese, operatorët e mjedisit, persona fizik e juridik palë të përfshira etj.

Ndërkaq masa të tjera për realizimin e opsionit të preferuar për të arritur qëllimet e politikës, do të ndërmerren masat :

- Regjistrimi i varieteteve të reja në katalogun kombëtar ;
- Përcaktimi i institucioneve përgjegjëse për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor si edhe për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve gjatë fazës së prodhimit deri në certifikim.
- Saktësimi i procedurave lidhur me regjistrimin e varieteteve të reja në mbështetje të një bujqësie të qëndrueshme.
- Nxitja për rritjen e numrit të certifikimeve të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, nëpërmjet disiplinimit të vendosjes në treg të materialit të pajisur me dokument që vërteton që është i certifikuar duke filluar nga viti 2026.
- Puna për identifikimin e direktivave, rregulloreve e BE-së në këtë fushë, përafrimi i të cilave në kuadrin ligjor shqiptar sjell plotësim standartesh europiane dhe përmirësimin e proceseve në këtë fushë. Konkretisht, gjatë takimit bilateral të zhvilluar në Bruksel në kuadër të **“Procesit Screening”** u identifikua nevoja e përafrimit të Direktivës 1999/05

EC “Për vendosjen në treg të materialit riprodhues pyjor¹²” e cila është parashikuar të përfshihet në PKIE 2025-2026 e cila do të punohet në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

- Akte nënligjore që ky projektligj parashikon të miratohen janë:
 - rregullat procedura dhe afatet për shqyrtimin e kërkesave përcaktohen me udhëzim të ministrit
 - Procedura të tjera për certifikimin zyrtar, përmbajtja, ngjyra dhe forma e etiketës zyrtare, përmbajtja dhe forma e certifikatës zyrtare, certifikatës së materialit mbjellës dhe mënyra e njoftimit të drejtuesit të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ministrit përgjegjës për pyjet dhe kullotat”;
 - Inspektimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor lidhur me plotësimin e kërkesave të përcaktuara për tregtim në këtë ligj, kryhet në bazë të planit vjetor të kontroleve zyrtare dhe marrjes së mostrave me bazë risku, të miratuar nga Ministri;
 - Katalogu Kombëtar publikohet në faqen zyrtare të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe të Ministrisë dhe përditësohet sa herë që pëson ndryshime. Forma, dhe përmbajtja e Katalogut Kombëtar miratohen me urdhër Ministri”.
 - Procedura dhe afatet e vlefshmërisë së regjistrimit të një varieteti në Katalogun Kombëtar miratohet me udhëzim Ministri”;
 - Përbërja, organizimi funksionimi i komisionit të Regjistrimit të Varieteteve (KRV-së), miratohet me urdhër të ministrit”.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të politikës është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nëpërmjet masave të mëposhtme:

- Masa monitoruese për zbatimit të procedurave të përcaktuara në ligj, janë raportimet që do kryhen nga inspektorët e Autoriteti Kompetent për Inspektimin e Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë inspekton produkteve e farërave dhe fidanëve në pikat kufitare gjatë import eksportit dhe Autoriteti kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve të cilët do të raportojnë mbi gjetjet e tyre në terren brenda vendit, lëvizjet e materialit mbjellës shumëzues bimor në tregje etj. Autoriteti kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve mund të gjenerojë të dhëna mbi sigurinë ushqimore në terren, kjo referuar numrit të masave të marra, këshillimeve, evidentimeve etj. ndaj operatorëve të biznesit në treg, analizave të kryera nga ISUV, kërkesave të dërguara për analiza etj. zbatimit të politikave të ministrisë etj.
- Të dhënat nga organet tatimore lidhur me eksportet- importet etj. do jenë raportet dhe studimet e institucioneve të tjera që bashkëpunojnë me MBZHR, raportime, masat administrative, zbatimi i planeve vjetore ose periodike etj. nga inspektorët e Autoritetit Kompetent për inspektimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe veterinerët zyrtarë të Autoriteti Kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve bazë të inspektimit të tyre në terren lidhur me gjëndjen e fitosanitare të materialit mbjellës, numri i certifikatave të lëshuara, numrin e analizave të kryera nga ESHFF etj.;

¹² Directive 1999/105 EC “On the marketing of forest reproductive material”.

- Raportet e marra nga QTTB, të cilat janë përgjegjëse për mbjelljen e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në pika strategjike me qëllim dhënien e një informacioni të plotë mbi përshtatshmërinë për zonat të catuar si edhe një mundësi transferimi të teknologjive të reja¹³.
- ESHFF monitoron rrjetin zonal për provat krahasuese për testim të cilave u nënshtrohen varietetet e reja të prodhuara në vend ose të importuara për riprodhim, shumëzim e tregtim. Mbi bazën e rezultateve të provave krahasuese dhe metodave laboratorike bën vlerësimin dhe regjistrimin në Katalogun Kombëtar(KK) si edhe mbrojtjen e interesave të fermerit, shtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, shtimin e varieteteve të reja në treg, rritjen e treguesve cilësorë të materialit mbjellës që tregtohet, si edhe për të siguruar një konkurrence të ndershme tregu.
- Indikatorët për të matur arritjen e objektivave janë si më poshtë:
 1. Numri i varieteteve të regjistruara në Katalogun Kombëtar;
 2. Numri i akteve nënligjore të miratuara;
 3. Numri i operatorëve të regjistruar dhe certifikuar pas nisjes së zbatimit të këtij optionsi;
 4. Rritja e vëllimit të eksporteve dhe importeve (ton dhe vlerë);
 5. Numri i shtuar i kontroleve të kryera nga autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar.
 6. Rritja e numrit të varieteteve të reja të regjistruara në Katalogun Kombëtar.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										

¹³Shënim: Me ristrukturimin e inspektoriateve dhe nga detyrimet që rrjedhin si rezultat i ndryshimeve nga ligji i ri “ Për inspektimin në republikën e shqipërisë”, strukturat inspektuese do të kenë emërtesa të ndryshuara për këtë shkak momentalisht janë cilësuar si në këto paragrafe.

Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e koston në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total										

Raporti i ndikimit të vlerësimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

Grupi i punës dhe RIA:

